



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25/2023 regjistër (JR)  
Datë 20.06.2023

Nr. 8 i vendimit  
Datë 26.02.2024

**V E N D I M**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtarë</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 26.02.2024, ditën e hënë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisionerja Publike, Irena Nino.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 651, datë 27.04.2023, për subjektin e rivlerësimit Urim Buci, me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisioneres Publike të paraqitura në ankim, parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, prapësimet e subjektit të rivlerësimit në gjykim e konkluzione përfundimtare, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi relatoren e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Urim Buci (në vijim “subjekti i rivlerësimit), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe, për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr.84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar<sup>1</sup> (në vijim “DSIK”) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Urim Buci, ka dërguar pranë Komisionit raportin<sup>2</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë së subjektit, në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar për pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>3</sup>, duke konstatuar, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Urim Buci.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit Urim Buci, i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>4</sup> të hollësishëm për vlerësimin e aftësive profesionale.

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10/2023, aktualisht ky institucion mban emrin “Autoriteti kombëtar për sigurinë e informacionit të klasifikuar”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.11.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.10.2017, të deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 9.12.2022, të KDZh-së.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2018.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 651, datë 27.04.2023, në bazë të germës “a”, të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi rezultatet e hetimit administrativ në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se ka arritur nivel të besueshëm, mbështetur në arsyetimet si vijojnë:

**3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** [...] (i) Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii). Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij; (iii). Mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e një pasurie para detyrës, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia; (iv) Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:** [...] Në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin indicie për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit, sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:** [...] Në përfundim, pas verifikimit dhe analizimit në mënyrë të pavarur të tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, trupi gjykues vlerësoi se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

## III. Shkaqet e ankimit

4. Komisionerja Publike Irena Nino, në konsideratë të aktit<sup>5</sup> “Rekomandim për paraqitje ankimi”, të nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit

<sup>5</sup> Të përcjellë pranë Institutit të Komisionarëve Publik me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.05.2023.

Ndërkombëtar të Monitorimit, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 651, datë 27.04.2023, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Urim Buci.

5. Komisionerja Publike ka parashtruar në ankim se nëpërmjet këtij mjeti procedural, në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 651, datë 27.04.2023, të Komisionit, nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”). Nëpërmjet ankimit, Komisionerja Publike ka adresuar shkaqe ankimi në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, duke kërkuar nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 651, datë 27.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Urim Buci.

#### **A. Shkaqe lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

6. Referuar përmbajtjes së ankimit Komisionerja Publike ka parashtruar shkaqe që i adresohen verifikimit të deklaramëve dhe kontrollit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, tokë arë dhe godinë banimi “3 kate + 1 kat papafingo”, në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, duke pretenduar se:

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë kontradiktore në deklaratën *vetting*, në deklaramët periodike, si dhe në përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, lidhur me vlerën e investuar për këtë pasuri dhe burimet e përdorura për krijimin e saj, të cilat çojnë në pamundësi të kontrollit dhe verifikimit të saktë të kohës, vlerës dhe burimit të krijimit të saj.

7. Për pasurinë tokë arë me sipërfaqe totale 1000 m<sup>2</sup>, në Kamëz, Tiranë, të blerë më datë 26.07.2007, si dhe për objektin banesë 3 kate + papafingo në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhurat e deklaruara me burim nga emigracioni i tij në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 2000-2004, që kanë shërbyer për financimin e këtyre pasurive, si për sa i përket përfitimit, ashtu edhe ligjshmërisë të tyre.
8. Komisionerja Publike pretendon se për balancën negative të pranuar prej Komisionit në vlerën (-) 7.514.635 lekë, e evidentuar në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit për të financuar me burime të ligjshme objektin në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, si dhe në vlerën (-) 464.014 lekë, për të mbuluar shpenzimet në vitin 2016, referenca dhe arsyetimi i Komisionit, bazuar në parimin e “proporcionalitetit” apo atë të “objektivitetit”, për të mos aplikuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe jo plotësisht i justifikuar në normativën kushtetuese dhe atë ligjore.
9. Komisionerja Publike pretendon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe ndalimit për të përfituar të mira, fonde publike nga kontratat publike, rrethanë, e cila duhet të merret për bazë në vlerësimin tërësor të rastit.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që i përket subjektit të rivlerësimit Urim Buci, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, mbi bazën e ankimit të Komisioneres Publike dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

11. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi nga Kolegji i ankimit ndaj nr. 651, datë 27.04.2023, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisionerja Publike, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

13. Në Kolegji, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar denoncimet e shtetasve R. D.<sup>6</sup> dhe Sh. B.<sup>7</sup>, që i adresohen subjektit të rivlerësimit Urim Buci. Në këto denoncime, denoncuesit parashitrojnë përkatësisht sa vijon.

13.1. Në denoncimin e shtetasit R. D., ngrihen pretendime lidhur me dy procedime penale që janë zhvilluar në ngarkim të tij dhe djalit të tij dhe i korrespondojnë përkatësisht vendimit për pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2017, për veprën penale “vetëgjyqësia” parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal dhe procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2021, për veprën penale “dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, në ngarkim të djalit të tij, D. D.. Për këto procedime penale, denoncuesi pretendon se ankimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë për vendimet gjyqësore që lidhen me to janë të padrejta.

13.2. Në denoncimin e shtetasit Sh. B., ngrihen pretendime se urdhri i nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 15.11.2023, me të cilin ka vendosur revokimin e urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 03.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për ekzekutimin e vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, të Gjykatës së Rrethit

<sup>6</sup> Të administruar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.08.2023.

<sup>7</sup> Të administruar në Kolegji me nr. nr. {\*\*\*} prot., datë 24.11.2023.

Gjyqësor Dibër, ndryshuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket denoncuesit si i dënuar, është një urdhër haptazi i padrejtë i nxjerrë në keqinterpretim të ligjit.

14. Trupi gjykues denoncimet e mësipërme ia komunikoi para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes subjektit të rivlerësimit, i cili, në seancën e datës 08.02.2024, paraqiti shpjegimet dhe aktet në mbështetje të tyre. Komisionerja Publike, pasi u njoh me prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore vijuese të datës 16.02.2024, parashtroi se nga vlerësimi i denoncimeve të publikut janë vërejtur të meta e mangësi të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, në aftësinë për të ndërmarrë hetimin apo për të kryer ekzekutimin e vendimit penal, të cilat, edhe pse të vetme, nuk mund të shërbejnë si bazë për aplikimin e masës së parashikuar në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, së bashku duhet të mbahen në konsideratë nga trupi gjykues në eventualitetin e vlerësimit tërësor të procedurës së rivlerësimit, sipas kërkesave të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

14.1. Trupi gjykues, pasi verifikoi pretendimet e ngritura në dy denoncimet e mësipërme dhe dëgjoi edhe qëndrimin e Komisioneres Publike lidhur me to, në konsideratë edhe të shpjegimeve dhe akteve të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se ato përmbanin elementë të mjaftueshëm që plotësonin kriteret e kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe vendosi t'i hetojë e vlerësojë çështjet e ngritura në to në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

15. Në përfundim të hetimit gjyqësor, trupi gjykues, shkaqet e ngritura në ankim dhe pretendimet përfundimtare të Komisioneres Publike, i vlerësoi duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato që u administruan gjatë procesit gjyqësor, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

**B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

**i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

16. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtrroi analizës shkaqet e ankimit, të cilat Komisionerja Publike i ka identifikuar si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, për të cilat arsyetohet sa vijon.

16.1. Në vendimin e Komisionit, në konkluzionet përfundimtare lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ndër të tjera është arritur në përfundimin sa vijon:

[...] ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.

16.2. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se për pasuritë “Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo”, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime kontradiktore në deklaratën vetting, në deklaratimet periodike, si dhe në përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, lidhur me vlerën e investuar për këtë pasuri dhe burimet e përdorura për krijimin e saj, të cilat çojnë në pamundësi të kontrollit dhe verifikimit të

*saktë të kohës, vlerës dhe burimit të krijimit të saj*, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

**16.3.** Fillimisht, trupi gjykues vlerëson të parashtrijë një konsideratë të përgjithshme rreth këtij shkaku ankimi të ngritur nga Komisionerja Publike, rreth kontrollit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si një ndër objektet e kontrollit në procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ia ka nënshtruar kontrollit dhe vlerësimit deklaratimet e subjektit mbi pasurinë e tij të përbërë prej dy sipërfaqe trualli në total prej 1000 m<sup>2</sup> dhe një godinë tre kate +1 papafingo, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë. Kjo pasuri është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, sipas *shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2018* ( në vijim “*deklarata vetting*”), si edhe në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2015. Për shkak të deklarimeve të paplota, të pasakta e më pas kontradiktore, Komisioni, përgjatë hetimit administrativ, ka kryer hetime të mëtejshme për të verifikuar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit rreth kësaj pasurie, në të gjitha komponentët e saj, që kanë të bëjnë me kohën e krijimit, vlerën e investuar, burimet e financimit dhe ka ngritur çështje rreth këtyre momenteve në tetë pyetësorë të drejtuar subjektit. Nga vendimi i Komisionit, por edhe nga leximi i përgjigjeve të subjektit përgjatë hetimit administrativ, rezulton se ai ka dhënë përgjigje të paplota dhe jo shteruese, duke shtuar elementë dhe fakte të reja në secilin prej pyetësorëve në varësi të çështjeve të ngritura prej Komisionit, duke krijuar në fund të këtij procesi një tablo të paqartë, të pashpjeguar dhe me të dhëna kontradiktore rreth elementeve të mësipërm, të cilat i vënë organet e rivlerësimit në pamundësi për të konkluduar me siguri për kohën e krijimit, vlerën e investimit e burimet e krijimit të kësaj pasurie. Këto kontradikta do të analizohen në vijim në detaje e do të shoqërohen, gjithashtu, me një vlerësim hipotetik të trupit gjykues, për secilin prej elementëve të mësipërm, që vjen si pasojë e pavërtetësisë, pasaktësisë e pamjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit rreth kësaj pasurie. Trupi gjykues, që në krye të arsyesimit e në vijim, çmon të nënvizojë faktin se, sipas parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka në këtë proces barrën e provës për të provuar të gjitha faktet e pretenduara/deklaruara prej tij, si edhe të kundërtën e fakteve me një nivel të pranuar të provueshmërisë, për të cilat organet e rivlerësimit duket se prezumojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**16.4.** Nga vendimi objekt shqyrtimi, rezulton se, pasi subjektit i është kaluar barra e provës me rezultatet e hetimit paraprak, lidhur me paqartësitë në deklaratime për sa i përket kohës së ndërtimit të objektit, Komisioni, pasi ka marrë shpjegimet e tij në përgjigje të saj, ka konkluduar se objekti tre kate në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, ka nisur të ndërtohet në mënyrë informale në vitin 1996 dhe pjesa tjetër është ndërtuar pasi është pajisur me leje ndërtimi në vitin 2008. Ndërtimi ka përfunduar në vitin 2015, para se subjekti të kishte filluar ushtrimin e funksioneve të prokurorit dhe se pas këtij viti nuk rezultojnë punime të tjera të kryera në të. Komisioni ka konkluduar, gjithashtu, se kati i dytë i objektit disponohet nga z. G. D.<sup>8</sup>, i cili duket se ka filluar të jetojë aty të paktën nga shkurti i vitit 2015. Në raport me këto konkluzione, Komisioni ka përlllogaritur vlerën e investimit në këtë objekt prej subjektit të rivlerësimit, duke shpërndarë investimin në vite, sipas shpjegimeve që ka dhënë subjekti

---

<sup>8</sup> G. D. është burri i motrës së subjektit të rivlerësimit, i cili në disa deklaratime nga vetë subjekti është identifikuar herë si “*kunati*” e herë si “*dhëndëri*”.

në përgjigjet e pyetësorëve të fundit<sup>9</sup> përgjatë hetimit administrativ, të cilat kanë diktuar përcaktimin e kohës së kryerjes së këtyre investimeve, fazat e ndërtimit të objektit dhe investitorin për secilën fazë. Në lidhje me vlerën e investimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka financuar ndërtimin e objektit në vlerën prej 7.514.635 lekësh për të gjithë pjesën e tij, duke pranuar shpjegimet e subjektit për investimin në katin e dytë të objektit të kryer prej kumatit të tij, z. G. D..

**16.5.** Komisionerja Publike, në mbështetje të shkakut ankimor se deklaratimet kontradiktore, lidhur me vlerën e investuar për pasurinë dhe burimet e përdorura për krijimin e saj, çojnë në pamundësi të kontrollit dhe verifikimit të saktë të burimit, kohës dhe vlerës së krijimit të kësaj pasurie, ka argumentuar se: *rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor duke referuar vlera të ndryshme për investimin e kryer në deklaratimet e tij në deklaratën vetting, deklaratën e vitit 2004, deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015 dhe përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, lidhur me vlerën/kostot e ndërtimit të pasurisë godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo. Deklarimet e subjektit, mbi ndërtimin e një pjesë të pasurisë nga shtetasi G. D. dhe mbulimin e kostove nga ky i fundit, duken kontradiktore, pasi në deklaratën e vitit 2015 (para fillimit të detyrës), subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar posedim apo investim nga ky shtetas, përkundër deklaratimit të tij në deklaratën vetting dhe deklarimeve gjatë hetimit administrativ. Deklarime kontradiktore konstatohen edhe lidhur me vlerën e ndërtimit dhe burimet e përdorura. Kështu në DV-2004, subjekti ka deklaruar vlerë ndërtimi prej 10.000.000 lekësh, me burim të ardhura të vëllait nga emigracioni. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, subjekti nuk deklaroi vlerë të pasurisë, deklaroi pjesë takuese 100%, ndërsa si burim deklaroi të ardhurat e tij nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004, pa përcaktuar shumën e këtyre të ardhurave. Në deklaratën vetting, subjekti deklaroi vlerën e ndërtimit prej 6.918.2015 lekësh, me pjesë takuese 100%, dhe burim të ardhura nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004 (pa deklaruar përsëri shumën e këtyre të ardhurave të realizuara), ndërkohë në prapësime gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon se është investuar prej tij vetëm vlera prej 3.576.580 lekësh.*

**16.6.** Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues analizoi deklaratimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë për objektin 3 kate në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, në deklaratën vetting, në deklaratimet vjetore periodike (në vijim “DVP”), në shpjegimet pranë ILDKPKI-së<sup>10</sup>, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me: **(a)** vlerën e investuar nga subjekti dhe pjesën e tij takuese (që ndikohet nga deklaratimet kontradiktore në lidhje me kumatit G. D.), si dhe kohën e realizimit të këtyre financimeve; **(b)** burimet e financimit të këtij objekti sipas DVP dhe deklaratës vetting dhe ato të deklaruara gjatë hetimit administrativ, për të cilat konstaton sa vijon.

**i. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:** *Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, ndërsa një pjesë është në proces legalizimi. Konkretisht, pjesa me leje ndërtimi është miratuar me vendim të KRRT-së, nr.*

---

<sup>9</sup> Me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti ka deklaruar se nuk është përfunduar plotësisht kati i parë i banimit (kati i dytë teknik) për një sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, ndërsa kanë përfunduar punimet për sipërfaqen 100 m<sup>2</sup> (ku përfshihet edhe sip. 62,55 m<sup>2</sup> e godinës ekzistuese, e cila është analizuar më lart), punime të cilat janë kryer kryesisht në vitin 2015.

<sup>10</sup> Të mbajtura respektivisht më datat 06 dhe 16 shtator 2016.



{\*\*\*} datë 03.07.2008, të Bashkisë Kamëz, për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m<sup>2</sup> (3 kate), sipërfaqe gjurmë ndërtimi 89 m<sup>2</sup> (kati i parë). Aktualisht janë përfunduar 3 kate. Objekti nuk është regjistruar akoma në ZVRPP-në Tiranë. Pjesa e objektit në proces legalizimi ka sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>, secili kat (3 kate) dhe në total të tria katet 150 m<sup>2</sup>.

Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G. D., pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G. D., i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh. Vlera: 6,918,105 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.

**ii. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2005** (dorëzuar në ILDKPKI më datë 12.10.2005), para fillimit të detyrës si Oficer i Policisë Gjyqësore më datë 01.08.2005 (në vijim “OPGj), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banesë dykatëshe me sip. 150 m<sup>2</sup>, e ndërtuar vetë në vitin 1995, e pa hipotekuar. E kam në bashkëpronësi me vëllain. Kjo ndërtesë është ndërtuar me të ardhurat e vëllait gjatë emigracionit. Pjesa takuese 50% në bashkëpronësi me vëllain. Viti i ndërtimit 1995. Vlera: 10.000.000 lekë. Burimi i krijimit: Kjo banesë është ndërtuar me të ardhurat e vëllait gjatë emigracionit*

**iii. Në deklaratën fillestare para fillimit të detyrës si prokuror të vitit 2015**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon: *Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, ndërsa një pjesë është në proces legalizimi. Konkretisht, pjesa me leje ndërtimi është miratuar me vendim të KRRT-së, nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të Bashkisë Kamëz, për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m<sup>2</sup> (3 kate), sipërfaqe gjurmë ndërtimi 89 m<sup>2</sup> (kati i parë). Aktualisht janë përfunduar 3 kate. Objekti nuk është regjistruar akoma në ZVRPP-në Tiranë. Pjesa e objektit në proces legalizimi ka sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>, secili kat (3 kate) dhe në total të tria katet 150 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 100%.*

*Burimi i krijimit: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.*

**16.7.** Nga analizimi i të dhënave të fashikullit të ILDKPKI-së, konstatohet se ky organ më datë 06.09.2016 ka mbajtur një procesverbal të emërtuar “*Mbi dorëzimin e dokumentacionit dhe shpjegimet përkatëse nga subjekti*”, në të cilin rezulton se i janë kërkuar sqarime subjektit për godinën 3 kate +1 kat papafingo (me leje ndërtimit si shtesë e objektit fillestar), të deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2015, për të shpjeguar nëse ky aset është i njëjtë me godinën e deklaruar në vitin 2005, si dhe të japë informacion për vlerën totale të investuar prej tij për ndërtimin e objektit, kur ka filluar ndërtimi, për pjesën takuese dhe burimin e përdorur. Subjektit i është kërkuar, gjithashtu, të japë arsyen e mosdeklarimit të vlerës së objektit në DVP-në 2015.

Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Objekti është ndërtuar si vazhdimësi e objekti të deklaruar në vitin 2005 dhe vlera e investuar nga emigracioni 2000-2004. Është në proces legalizimi (viti 2015) në emrin tim një pjesë e godinës, e cila është ndarë pothuaj në dy pjesë të barabarta, duke u bazuar në ndarjen e tokës prej 1000 m<sup>2</sup> në dy pjesë të barabarta, pjesa tjetër ka leje ndërtimi. Vlera e investuar nuk është deklaruar për pamundësi*

*llogaritjeje, pasi është ndërtuar nga vëllai, nuk është nxjerrë leja e shfrytëzimit dhe nuk është kryer akti i kolaudimit. Kati papafingo nuk është ndërtuar pavarësisht se figuron në leje ndërtimi. Aktualisht banoj në katin e dytë, kati i përdhe është i pabanuar dhe i pashfrytëzuar (ndërtuar për biznes, kurse në katin e tretë banon dhëndri im pa detyrim për momentin.*

**16.8.** Në ILDKPKI, sipas të dhënave të procesverbalit vijues të mbajtur në këtë institucion më datë 16.09.2016, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar për shtëpinë dykatëshe të deklaruar në DVP-në 2005, ka dorëzuar aktet si vijon: **(i)** lejen e ndërtimit miratuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të KRRT-së, Bashkia Kamëz, për objekt “Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo”, me investitor Urim Buci, kontratë me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, lagja {\*\*\*}, Kamëz, Tiranë, me sip. e sheshit të ndërtimit prej 724 m<sup>2</sup>, gjurmë e ndërtimit 89 m<sup>2</sup> dhe sip. totale e ndërtimit 318 m<sup>2</sup>; **(ii)** dokumentin e depozituar pranë ALUIZNI-t që mban datën 26.12.2014 (protokolluar më datë 07.01.2015), të emërtuar “vetëdeklarim”, të nënshkruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit, me anë të të cilit kërkohet përfshirja në procedurat e legalizimit të objektit tre kate në adresën: rruga “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, Kamëz, Tiranë, të ndërtuar në vitin 2006; si dhe **(iii)** foto të printuara të objektit në gjendjen aktuale.

**16.9.** Në përgjigjet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 06.09.2016 dhe datë 16.09.2016, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar vlerën e objektit (*godinës së vjetër me sip. 150m<sup>2</sup>*) në një total prej 10.000.000 lekësh dhe ka saktësuar se kjo vlerë është deklaruar në lekë të vjetra. Ndërsa referuar objektit “3 kate + 1 papafingo”, subjekti ka paraqitur krahas akteve të mësipërme dhe “situacionin e punimeve” mbi vlerën e investuar prej 6.918.105 lekësh, vlerë e cila, sipas deklarimit të subjektit, është investuar prej tij me të ardhurat nga emigracioni në Angli në vitet 2000-2004. Nga ky dokumentacion rezulton se akti i emërtuar “Situacioni i punimeve për objektin “3 kate +1 kat papafingo”, i cili është nënshkruar më datë 15.09.2016, nga përfaqësuesit e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përmban shënimin: “1. Ky situacion përfshin dy kate të përfunduara dhe një kat (kati i dytë teknik) në fazën e karabinasë (sipas lejes së ndërtimit), si dhe katin e dytë teknik në objektin ekzistues dy kat. 2. Një pjesë e punimeve është kryer nga vetë familjarët”.

Në ILDKPKI, së bashku me deklaratën *vetting* të dorëzuar më datë 26.01.2017, subjekti ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2017, në të cilën ai deklaron se z. G. D. është *posedues*, pasi është *investitor i katit të 3-të*, të objektit me leje ndërtimi dhe objektit ekzistues.

**16.10.** Trupi gjykues, konstaton se Komisioni me pyetësin nr. 2<sup>11</sup>, nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, lidhur me kohën dhe vlerën e investuar në objektin “3 kate +

---

<sup>11</sup> Me pyetësin nr. 2, Komisioni, për objektin në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë i ka kërkuar subjektit sqarime të shoqëruara me dokumentacion tekniko-ligjor për sa vijon:

- Kur është ndërtuar objekti 2-katësh? Sqaroni deklaratimet tuaja ndër vite në lidhje me këtë objekt.
- Nëse kemi të bëjmë me të njëjtin objekt 2-katësh të deklaruar në deklaratën e vitit 2005, shpjegoni pse në formularin e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t keni deklaruar periudhën e ndërtimit vitin 2006.
- Duke ju referuar përmbajtje së situacionit të punimeve të datës 15.06.2016, në të cilin përfshihet edhe kati i dytë në objekti, shpjegoni nëse ky objekt 2-katësh është ndërtuar nga shoqëria ndërtimit (“{\*\*\*}” ShPK) ose jo? Nëse jo, shpjegoni kush i ka kryer punimet për ndërtimin e objektit 2-katësh. Në çdo rast, deklaroni vlerën e punimeve të ndërtimit për këtë objekt.
- Kur është ndërtuar objekti 3-katësh? A është regjistruar në ASHK ky objekt dhe është pajisur me certifikatë pronësie? Nëse po, ju lutem përcillni dokumentet përkatës.

papafingo”, në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me kohën e ndërtimit të objektit<sup>12</sup>, vlerën e tij dhe burimet e financimit.

**16.11.** Lidhur me këtë kërkesë, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri, ka shpjeguar e deklaruar sa vijon:

*Objekti 3-katësh ka filluar së ndërtuari që në vitin 2008 dhe ka përfunduar në vitin 2010 si karabina (kolona, soletë dhe mur me tulla), sipas lejes së ndërtimit. Nga muaji shtator dhe aktualisht, kati përdhe është i përfunduar. Shtesa e re e katit të parë banim është karabina (aktualisht është i papërfunduar) dhe pjesa e vjetër e objektit 2-katësh është përfunduar dhe shfrytëzuar si shtëpi banimi. Kati i dytë banim (shtesa e re) nga ana ime është bërë vetëm karabina dhe është përfunduar e shfrytëzohet aktualisht për banim nga shtetasi G. G. D. (dhëndri im), i cili i ka kryer punimet vetë dhe më datë 09.11.2021 është pajisur me certifikatë pronësie për katin e dytë banim.*

*Vlera e objektit 3-katësh referuar lejes së ndërtimit për sip. totale 318 m<sup>2</sup>, sipas situacionit të punimeve të datës 15.9.2016 është deklaruar në vlerën 6.918.105 lekë, por nga kjo vlerë duhet të hiqet vlera e katit të dytë banim, pasi punimet janë kryer dhe është përfunduar e shfrytëzuar për banim nga vetë shtetasi G. D. Kjo për faktin se siç kam përmendur me sipër dhe në deklaratat e pasurisë ndër vite, kati i dytë banim aktualisht në pronësi të G. D. nga ana ime është kryer vetëm ndërtimi si karabina. Gjithashtu, nga vlera 6.918.105 lekë, sipas situacionit të punimeve të datës 15.09.2016, duhet të zbritet edhe vlera e katit të parë banim (shtesa e re), e cila aktualisht është pa përfunduar. Të dyja këto vlera do të qëndronin si pjesë e situacionit nëse objekti do të ishte përfunduar tërësisht nga ana e subjektit. Ky fakt provohet dhe në situacionin e punimeve të datës 15.09.2016 në rubrikën shënime<sup>13</sup>. Këto të dhëna provohen gjithashtu dhe nga “aktkonstatimi” i punimeve të datës 23.11.2022, ku provohet fakti që nga unë subjekti është investuar gjatë viteve 2008-2015, vlera totale prej 3.576.580 lekësh.*

**16.12.** Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur në Komision një tjetër akt me natyrë teknike të emërtuar “aktkonstatimi” të hartuar më datë 23.11.2022, nga ing. Gj. M., për objektin “Shtesë anësore dhe shtesë në lartësi në objektin ekzistues 1 kat” (objekti përfundimtar: “Godinë shërbimi dhe banimi 3 KT”), me investitor z. Urim H. Buci e z. G. D., me vendndodhje në Bashkinë Kamëz, në të cilin janë përkthuar punimet, investitorët dhe periudhat kur janë kryer ato si vijon:

- 
- Kur janë kryer punimet në objektin 3-katësh dhe sa ka qenë vlera e tyre?
  - A është përfunduar ndërtimi i parafangos në këtë objekt? Në punësi të kujt është ajo dhe sa është vlera e shpenzuar për ndërtimin e saj?
  - A kanë lidhje me njëri-tjetrin dy objektet e deklaruara si më lart (objekti 2-katësh dhe 3-katësh) apo janë objekte të ndryshme?

<sup>12</sup> Objekti në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, rezulton të jetë i përbërë nga kati përdhe, i referuar në këtë vendim si kati i parë; nga kati i parë teknik mbi atë përdhe, i referuar në këtë vendim si kati i dytë; si dhe nga kati i dytë teknik, i referuar në këtë vendim si kati i tretë.

<sup>13</sup> Rubrika shënime e situacionit të punimeve të hartuar nga shoqëria ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, përkthuar se: Ky situacion përfshin dy kate të përfunduara dhe një kat (kati i dytë teknik) në fazën e karabinasë (sipas lejes së ndërtimit), si dhe katin e dytë teknik në objektin ekzistues dy kat. 2. Një pjesë e punimeve është kryer nga vetë familjarët.

- a) në vitet 2008-2010 (karabina-shtesë anësore në objekt ekzistues), nga investitor Urim Buci, me vlerë 1.238.680 lekë;
  - b) në vitet 2010-2015 (rifiniturat-shtesa anësore në objekti ekzistues), nga investitori Urim Buci, me vlerë 2.337.900 lekë;
  - c) në vitet 2008-2010 (karabina-shtesa kt. 2-të), investitor G. D., me vlerë 1.139.600 lekë;
  - d) në vitet 2010-2015 (rifiniturat shtesa kt. 2- të), investitor G. D., me vlerë 1.052.360 lekë.
- Sipas këtij aktkonstatimi, shuma totale e investuar nga z. Urim Buci është 3.576.580 lekë, ndërsa shuma e investuar nga z. G. D. është 2.191.960 lekë.

**16.13.** Përveç aktit teknik “aktkonstatimi” të datës 23.11.2022, të evidentuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision edhe aktet me të dhënat si vijon: **(a)** deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.06.2018, me deklarues subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur S. B. (bashkëshortja) dhe z. G. D., të cilët kanë deklaruar *se në objektin e vetëdeklaruar datë 26.12.2014 (të ndërtuar fillimisht me vëllain në mënyrë informale), Urim dhe S. B. janë bashkëpronarë në 2/3 e tij, konkretisht në katin e parë për biznes dhe katin e dytë banim, ndërsa kati i tretë është i G. D., me funksion banimin. Por, po në të njëjtën deklaratë, Urim dhe S. B. deklarojnë se: “Të dy katet janë tonët, ndërsa kati i tretë për banim është në bashkëpronësi me G. D.”;* **(b)** leje legalizimi, datë 12.07.2018, për objektin “godinë e kombinuar 3 kate”, në favor të Urim H. Buci dhe G. G. D., specifikon sip. e parcelës ndërtimore prej 87,05 m<sup>2</sup>, sip. e ndërtimit prej 59,2 m<sup>2</sup> dhe sip. totale të ndërtimit për banim prej 125,1 m<sup>2</sup> dhe sip. për aktivitetet prej 62,55 m<sup>2</sup>. Rezulton se objekti është regjistruar<sup>14</sup> në datën 14.02.2019 me nr. pasurie {\*\*\*}, në bashkëpronësi të ½ pjesë Urim Buci dhe ½ pjesë G. D., me sip. totale ndërtesë 59,20 m<sup>2</sup>; **(c)** deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2018, me deklarues Urim Buci dhe G. D., në të cilën është deklaruar se ata janë pajisur me leje legalizimi<sup>15</sup> për objektin e sipërpërmendur dhe se në të, z. Urim Buci është disponues i katit përdhe dhe katit të parë, ndërsa z. G. D. është disponues i katit të tretë.

**16.14.** Nga analizimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka përlllogaritur vlerat e objekteve (pjesës ekzistuese dhe shtesën me leje ndërtimit) mbështetur në të dhënat si vijon.

<sup>14</sup> Sipas korrespondencës me ASHK/Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.03.2021 janë përcjellë kopje të certifikatës së pronësisë ku në zërin “përshkrim i veçantë” sqarohet: sip. kt. përdhe = 59,2 m<sup>2</sup>, sip. kt i parë = 62,55 m<sup>2</sup>, sip. kt. i dytë = 62,55 m<sup>2</sup>.

<sup>15</sup> Referuar në korrespondencën e Komisionit me ASHK-në, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.02.2023, ku ndodhet dhe kontrata e pjesëtimit vullnetar nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.11.2021, rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.08.2021, të ASHK/DV Kamëz Vorë, është miratuar legalizimi i ndërtimit pa leje 3 kat (shtesë anësore) poseduar nga z. Urim H. Buci dhe z. G. G. D.. Sipërfaqja ndërtimore për banim është 250,7 m<sup>2</sup>, sip. e bazës së ndërtimit (social ekonomik) është 111,1 m<sup>2</sup>, ndërsa sip. e parcelës ndërtimore është 188,5 m<sup>2</sup>. Pas bashkimit të dy pasurive të legalizuara me dy lejet e legalizimit (të vitit 2018 dhe 2021), është bërë pjesëtimi vullnetar i tyre, sipas së cilit z. Urim Buci ka marrë në pronësi katin përdhe dhe katin e parë, ndërsa z. G. D. ka marrë në pronësi katin e dytë.

Në bazë të pjesëtimit të bërë si më lart, në nëntor të vitit 2021, subjekti i rivlerësimit Urim Buci dhe z. G. D. janë pajisur me certifikatat e pronësisë, sipas pjesëve takuese për objektin “Godinë e kombinuar 3 kat”, me adresë në Kamëz. Konkretisht:

- pas. {\*\*\*}, lloji i pasurisë “njësi”, sip. 132,48 m<sup>2</sup>, z. k. {\*\*\*}, pronar Urim Buci;
- pas. {\*\*\*}, lloji i pasurisë “apartament”, sip. totale 180,65 m<sup>2</sup>, pronar Urim Buci;
- pas. {\*\*\*}, lloji i pasurisë “apartament”, sip. totale 175.1 m<sup>2</sup>, pronar G. D..

**16.15.** Për pjesën ekzistuese të objektit ndërtuar që në vitin 2005 (pa leje ndërtimi), Komisioni ka konsideruar: **(i)** deklaratimet e subjektit si OPGj në deklaratën e pasurisë të vitin 2005<sup>16</sup> dhe vetëdeklarimin<sup>17</sup> pranë ALUIZNI-t (deklarimin që objekti është ndërtuar nga vëllai dhe të dhëna mbi sip. e objektit ekzistues); **(ii)** shpjegimet<sup>18</sup> që subjekti ka dhënë në Komision me përgjigjet për pyetëtorin nr. 2 dhe pyetëtorin nr. 5, në të cilat deklaroi se vëllai i tij, shtetasi D. B. ka kryer punimet e ndërtesës dy kate duke ndërtuar plotësisht katin përdhe dhe karabinanë e katit të parë banim; **(iii)** shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetëtorit nr. 7<sup>19</sup> të Komisionit, në të cilin ka deklaruar se punimet e mbylljes së ndërtimit në katin e parë<sup>20</sup> banim janë kryer nga subjekti gjatë vitit 2015; **(iv)** informacionin e ofruar nga fotografimi ajror (ortofoto) i vitit 2009, në të cilin karabinaja e katit të tretë rezultoi e përfunduar.

**16.16.** Nga vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit, rezultoi se mbi bazën e të dhënave të mësipërme, për shtesën mbi pjesën ekzistuese të ndërtuar që në vitin 2005 të këtij objekti, për efekt të analizës financiare, ka konkluduar se vlera e investimit të realizuar gjatë viteve 2008-2015 nga subjekti i rivlerësimit në ndërtesën ekzistuese (*kati i I-rë ndërtim i plotë dhe kati i II-të vetëm karabina*) është në shumën 1.528.601 lekë.

**16.17.** Sa i takon pjesën së objektit, ndërtuar me lejen e ndërtimit<sup>21</sup> të vitit 2008 (shtesë anësore 3 kate+ dhe në lartësi), Komisioni ka konsideruar në vlerësimin e tij: **(i)** të dhënën se nga ortofotot e vitit 2009, duket e përfunduar karabinaja e ndërtesës 3 kate (shtesa me leje ndërtimi), si edhe karabinaja e katit të tretë të godinës ekzistuese. Ndërsa në fotot e përcjella prej subjektit në ILDKPKI, me përgjigjet e procesverbalit të datës 06.09.2016 dhe nga fotot e marra nga Google Map<sup>22</sup> të realizuara në maj 2016, duket se kanë përfunduar punimet e ndërtimit në katin përdhe të shtesës anësore të godinës, kati i parë i banimit është pjesërisht karabina dhe kati i dytë i banimit (kati i tretë teknik) në të dyja pjesët e godinës (ekzistuese dhe shtesa anësore) është i ndërtuar plotësisht; **(ii)** përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për pyetëtorin nr. 2, në të cilat ka sqaruar se objekti 3-katësh ka filluar ndërtimin në vitin 2008 dhe ka përfunduar në vitin 2010 si karabina dhe se nga muaji shtator 2015 dhe aktualisht kati përdhe ka përfunduar, kati i parë i banimit është karabina, ndërsa në katin e dytë janë kryer vetëm punimet e karabinasë, të cilat janë vijuar më tej nga z. G. D.. Sipas “aktkonstatimit të punimeve”, bashkëlidhur pyetëtorit nr. 2, vlera e punimeve të karabinasë në shtesën anësore të kryera gjatë periudhës 2008-2010 (në pjesën me leje ndërtimi) është me vlerë totale 1.238.680 lekë; **(iii)** përgjigjet e subjektit për pyetëtorin nr. 7, në të cilin ka shpjeguar se nuk është përfunduar plotësisht kati i parë i banimit (kati i dytë teknik), për një sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, ndërsa kanë përfunduar punimet për sipërfaqen 100 m<sup>2</sup> (ku përfshihet edhe

<sup>16</sup> Deklaron se ka në bashkëpronësi me vëllain një banesë dykatëshe, të cilën e kanë ndërtuar vetë në vitin 1995 dhe është e pa hipotekuar. Ka deklaruar se në këtë banesë ai zotëron 50% dhe se vlera e saj në momentin e krijimit është 10.000.000 lekë (të vjetra). Kjo banesë është ndërtuar me të ardhurat e vëllait nga emigracioni.

<sup>17</sup> Kërkesë e plotësuar prej tij më datë 26.12.2014 dhe protokolluar prej ALUIZNI-t më datë 07.01.2015, ku deklaroi se viti i ndërtimit të objektit është 2006.

<sup>18</sup> Pyetësor nr. 2 (përgjigje e pyetjes nr.1) dhe shtojca e aktit të konstatimit, datë 23.11.2022, përcjellë me pyetësor nr. 5.

<sup>19</sup> Pyetja 3.2.

<sup>20</sup> Me pyetësor nr. 2, subjekti ka përcjellë aktkonstatim e punimeve, datë 23.11.2022, në të cilin është përfshirë edhe vlera e investimit të mbylljes së ndërtimit në katin e parë të banimit, por si pjesë e pandarë e punimeve të sip. 100 m<sup>2</sup> në këtë kat.

<sup>21</sup> Sipas vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të KRRT-së së Bashkisë Kamëz.

<sup>22</sup> <https://www.google.com/maps>

sip. 62,55 m<sup>2</sup> e godinës ekzistuese, e cila është analizuar më lart), punime të cilat janë kryer kryesisht në vitin 2015. Gjithashtu, Komisioni ka konsideruar edhe shpjegimin e dhënë nga subjekti gjatë hetimit administrativ me përgjigjet e pyetësorit nr. 7 se z. G. D. ka filluar të jetojë në katin e tretë (katin e dytë të banimit) të objektit në fjalë në vitin 2015, duke e faktuar këtë të dhënë me një kontratë kredie bankare të datës 12.12.2014, në të cilën z. G. D. ka firmosur në cilësinë e dorëzuesit dhe ka deklaruar se adresa e banimit është në “{\*\*\*}”, banesë nr. 1, Kamëz (aktualisht rruga “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë), si dhe me lidhjen e një kontrate të furnizimit të energjisë elektrike në funksion të së cilës subjekti i rivlerësimit më datë 20.02.2015 ka lëshuar një deklaratë noteriale ku ka deklaruar se është dakord që kontrata e mëparshme e lidhur midis tij dhe OShEE-së, të lidhet midis OShEE-së dhe z. G. D.. Mbi bazën e këtij informacioni, Komisioni ka përllogaritur vlerën e investimit të kryer nga subjekti dhe ka konkluduar se totali i saj në pjesën e godinës me leje ndërtimi është 5.986.035 lekë.

**16.18.** Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, prapësoi pretendimet e Komisioneres Publike duke parashtruar se në kushtet kur objekt kontrolli për procesin e rivlerësimit kalimtar është deklarata *vetting*, ai duhet konsideruar se ka deklaruar në mënyrë të saktë në këtë deklaratë kohën, mënyrën e krijimit dhe vlerën totale të investuar për ndërtimin e objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se në deklaratën *vetting* ka deklaruar edhe faktin që investimi i katit të tretë të këtij objekti është kryer nga z. G. D., si dhe faktin se burimi i krijimit të vlerës së investuar për pjesën e ndërtimit të kryer prej subjektit janë të ardhurat nga emigracioni në vitet 2000-2004. Përveç sa më sipër, subjekti prapësoi dhe shpjegoi se:

**16.18.1.** Vlera 10 milion lekë, e deklaruar për pjesën ekzistuese të objektit në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 (dorëzuar në tetor të vitit 2005), duhet të konsiderohet si lapsus, pasi ajo në realitet është 1 milionë lekë të rinj, si dhe ka sqaruar si është zhvilluar objekti nga vitit 2005 e në vijim. Është i vërtetë fakti që në deklaratën para fillimit të detyrës subjekti nuk ka deklaruar vlerën e objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, por duhet të konsiderohet se ky deklaram është plotësuar dhe saktësuar me shpjegimet që ka dhënë në ILDKPKI në vitin 2016, ku ka deklaruar vlerën e këtij objekti, i cili, po njësoj, është cilësuar edhe në deklaratën *vetting*.

**16.18.2.** Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti në deklaratën *vetting* në rubrikën e të ardhurave nuk ka deklaruar vlerën e siguruar nga emigracioni, ka shpjeguar se nuk ka deklaruar një vlerë të saktë të këtyre të ardhurave, për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor që vërtetonte realizimin e tyre, të cilat kanë qenë rreth 60.000 GBP, të krijuara nga një e ardhur mujore prej 1250 GBP, duke deklaruar, gjithashtu, se ka përllogaritur në mënyrë të përafërt se shuma e kursyer nga këto të ardhura, e dërguar pranë familjes, ka qenë në vlerën prej 30.000 GBP.

**16.18.3.** Vlera prej 3.576.580 lekësh, e paraqitur në prapësime gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk përfaqëson një vlerë në kontradiktë me vlerën 6.918.205 lekë, e cila në fakt përfaqëson vlerën e të gjithë objektit të ndërtuar pas vitit 2005, vlerë e cila, nga përshkrimi i bërë në deklaratën *vetting* në kolonën e emërtuar “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, rezulton qartësisht se për katin e tretë është investuar nga kuantiti, z. G. D..

**16.19.** Trupi gjykues, me qëllim analizimin e plotë të këtij shkakut ankimi, pasi u njoh pretendimet e Komisioneres Publike, si dhe shpjegimet e prapësimet e subjektit të rivlerësimit të dhëna në Komision dhe në Kolegj, vlerësoi se elementet të cilët kanë ndikim në vlerën e objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, kanë të bëjnë me kostot e ndërtimit dhe metodologjinë e përlllogaritjes së tyre, si dhe përfshirjen e z. G. D. si investitor i të katit të fundit të objektit.

**16.20.** Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, ato të përcjella nga ILDKPKI, si dhe të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë objekt, konstaton disa rrethana që vlerësohen të rëndësishme për t’i dhënë përgjigje çështjeve të shtruar për zgjidhje, si vijon: Në deklaratën fillestare 2005, në DVP-në 2015 dhe në DVP-në 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë vlerë për këtë objekt (*si për pjesën ekzistuese të ndërtuar para vitit 2005, ashtu edhe për pjesën 3 kate + 1 kat papafingo, për të cilën është pajisur me leje ndërtimit*).

**16.20.1.** Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, ashtu edhe në deklaratimet e bëra në ILDKPKI më datë 16.09.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e deklaroi si investitor të katit të 3-të katin, z. G. D., për të cilin disa ditë më parë (më datë 06.09.2016), po në ILDKPKI, ka deklaruar se banon në katin e 3-të të objektit pa detyrim për momentin. Lidhur me vlerën e objektit, subjekti pranë ILDKPKI-së ka deklaruar se sipas të dhënave të aktit me natyrë teknike të emërtuar “*situacioni i punimeve*” i datës 15.09.2016, i hartuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e cila, sipas lejes së ndërtimit, është kompania ndërtuese e tij, vlera është 6.918.105 lekë.

**16.20.2.** Në deklaratën *vetting*, për objektin 3 kate + 1 kat papafingo, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: vlera është 6.918.105 lekë; pjesa e tij takuese është 100% dhe *kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G. D., pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë*.

**16.20.3.** Pranë ALUIZNI-t, në funksion të procesit të legalizimit, subjekti i rivlerësimit në datën 26.12.2014 ka plotësuar formularin e *vetëdeklarimit*, me anë të të cilit ka kërkuar legalizimin e objektit në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, për të cilin nuk figuron si bashkëinvestitor e as si bashkëdeklarues z. G. D.. Në këtë proces, rezulton se për legalizimin e objekti “*3 kate + 1 kat papafingo*”, janë bërë ndryshime duke bërë pjesë të tij edhe z. G. D., në kohën kur është përpiluar deklarata *vetting*.

**16.20.4.** Vetëm nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2017<sup>23</sup>, subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë se z. G. D. është posedues, pasi është investitor i katit të 3-të të objektit me leje ndërtimi dhe objektit ekzistues.

---

<sup>23</sup> Nga të dhënat e akteve të mësipërme rezulton se pasi është hartuar deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2017, subjekti i rivlerësimit një ditë më pas, më datë 26.01.2017, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën *vetting* me shpjegimin/deklarimin se: “*Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G. D., pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G. D., i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh*”. Vlera: 6.918.105 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**16.20.5.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit përveç situacionit të punimeve ka paraqitur një akt tjetër me natyrë teknike të emërtuar “aktkontrolli” për objektin “shtesë anësore dhe shtesë në lartësi në objektin ekzistues 1 kat (objekti përfundimtar: “Godinë shërbimi dhe banimi 3 KT), i hartuar nga ing. Gj. M. më datë 23.11.2022 (i cili ka qenë inxhinieri zbatues i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, që ka nënshkruar edhe situacionin e punimeve të cituar më lart), ku janë përshkruar punimet, investitorët dhe periudhat kur janë kryer, duke identifikuar se vlera e investuar në këtë objekt nga subjekti i rivlerësimit Urim Buci është 3.576.580 lekë, ndërsa shuma e investuar nga z. G. D. është 2.191.960 lekë.

**16.20.6.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, për të provuar përfshirjen e kumatit G. D. në investimin për ndërtimin e katit të 3-të në objektin në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, ka paraqitur si provë edhe kontratat e lidhura për furnizimin me energji elektrike<sup>24</sup> të këtij objekti, nga të cilat rezulton se fakti i lidhjes së kësaj kontrate me nr. {\*\*\*}, me kod klienti {\*\*\*}, hapur më datë 20.04.2015, provon pretendimin e subjektit për përfshirjen e z. D. si investitor i katit të 3-të.

**16.21.** Në funksion të evidentimit të kostove dhe të kohës së ndërtimit të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, trupi gjykues, fillimisht mori në analizë informacionin që ofrojnë aktet me natyrë teknike të emërtuar përkatësisht “situacioni i punimeve” dhe “aktkontrolli” nga i cili konstatoi se:

**16.21.1.** Dokumenti teknik i emërtuar “aktkontrolli” i hartuar përgjatë hetimit administrativ, (datë 23.11.2022) rezulton të jetë i ndryshëm nga situacioni i punimeve të këtij objekti i datës 15.09.2016, akt ky i dorëzuar të nesërmen e kësaj date nga subjekti në ILDKPKI, në funksion të raportit që kjo strukturë ndihmëse, sipas përcaktimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, tashmë të miratuar, do të hartonte për subjektin e rivlerësimit.

**16.21.2.** Trupi gjykues konstaton se akti i emërtuar “situacioni i punimeve”, i hartuar në datën 15.09.2016 nga përfaqësues të shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, evidenton për objektin “3 kate +1 kat papafingo”, volumet, zërat e punimeve dhe çmimet përkatëse dhe përcakton si kosto të këtij objekti, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh-në), vlerën 6.918.105 lekë. Trupi gjykues vëren se akti teknik i cilësuar si “situacioni i punimeve” mban shënimin: “1. Ky situacion përfshin dy kate të përfunduara dhe një kat (kati i dytë teknik) në fazën e karabinasë (sipas lejes së ndërtimit), si dhe katin e dytë teknik në objektin ekzistues dy kat. 2. Një pjesë e punimeve është kryer nga vetë familjarët”.

**16.21.3.** Pavarësisht se aktkonstatimi i datës 23.11.2022 është nënshkruar nga i njëjti inxhinier ndërtimi (z. Gj. M.), i cili ka firmosur dhe situacionin e punimeve të vitit 2016, në cilësinë e

---

<sup>24</sup> Referuar kontratës për furnizimin me energji të katit të parë, subjekti ka përcjellë në Komision deklaratën noteriale të datës 20.02.2015, në të cilën subjekti ka deklaruar se është dakord që kjo kontratë e lidhur midis tij dhe OShEE-së të lidhet midis OShEE-së dhe z. G. D.. Në lidhje me këtë kontratë, subjekti ka sqaruar se “punonjësit e OShEE-së, dega Kamëz, në fillim kanë bërë një ngatërrësë duke vënë këtë kontratë në emër të dhëndrit G. G. D., ndërsa kontratën e katit të dytë banim në emrin tim Urim H. Buci. Aktualisht janë bërë ndryshimet përkatëse duke sistemuar kontratat sipas pronësisë faktike të kateve të objektit (kontratat e katit përdhe/njësi shërbimi dhe katit të parë banim në emrin tim Urim H. Buci, ndërsa kontrata e katit të dytë banim në emër të z. G. G. D.)”. Ndryshimi i kontratave nga G. D. në Urim Buci është bërë në datën 27.08.2021. Kontrata me nr. {\*\*\*}, me kod klienti {\*\*\*}, hapur në datën 20.04.2015 (për katin e dytë banim) dhe në datën 27.08.2021, është bërë ndryshim emri nga Urim Buci në G. D..



drejtuesit teknik të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duket se dhe vlera e situacionit të punimeve të datës 15.09.2016 është pothuaj e njëjtë me vlerën e aktit të konstatimit të datës 23.11.2022, aktet ndryshojnë nga njëri-tjetri, pasi në këtë të fundit volumet e punës janë shpërndarë sipas kateve të objektit, periudhës së investimit dhe investitorëve përkatës, ndërkohë që situacioni volumet i ka të grupuara sipas zërave të punimeve.

**16.21.4.** Trupi gjykues konstaton se situacioni i vitit 2016<sup>25</sup> konfirmon përfundimin e punimeve në katin përdhe, katin e dytë të objektit, në fazë karabinaje të katit të dytë për objektin me leje ndërtimi, si dhe katin e tretë në objektin ekzistues, ndërsa akti i konstatimit konfirmon përfundimin e objektit *shtesë anësorë dhe shtesë në lartësi në objektin ekzistues I kat (objekti përfundimtar: Godinë shërbimi dhe banimi 3 KT)*, në këtë mënyrë rezulton se situacioni i datës 15.09.2016, certifikon një vlerë punimesh në shumën 6.9 milion lekë për një objekt të papërfunduar, ndërsa akti i konstatimit<sup>26</sup> i hartuar në vitin 2022, gjashtë vite më pas, përcakton kryerje punimesh në shumën 6.9 milion lekë për një objekt të përfunduar plotësisht. Nga leximi i detajuar i të dy akteve rezulton se volumet dhe çmimet e paraqitura në situacionin e vitit 2016 janë ndryshuar në dokumentin e ri të quajtur aktkonstatim i vitit 2022, duke zvogëluar volumet (sasisë) dhe ndryshuar çmimet për njësi, me projeksionin final që vlera totale e të dy akteve të jetë pothuaj e njëjtë, modifikime që duket se kanë përshtatur aktin e konstatimit me qëllimin që të mos ndryshojë vlera e përcaktuar në situacionin e punimeve të datës 15.09.2016.

**16.21.5.** Duke lexuar logjikshëm të dhënat e përshkruara më lart dhe ndryshimet mes këtyre dy akteve teknike, trupi gjykues çmon se akti i konstatimit i hartuar në vitin 2022, për një objekt të pajisur me një situacion punimesh të certifikuar 6 vite më parë (*akte këto të dyja të nënshkruara nga i njëjti inxhinier*), mundet vetëm të evidentojë nëse ka punime shtesë dhe vlerën e tyre dhe jo të modifikojë punimet e kryera më parë, të cilat duhet të mbeten të pandryshueshme, pasi nuk ka asnjë mundësi objektive që ato të kenë ndryshuar volum dhe, për pasojë, edhe vlerë. Trupi gjykues vlerësoi të dhënat e përftuara prej këtyre akteve, sipas analizës së mësipërme, duke konsideruar të pabesueshëm informacionin e përcjellë nga aktkontrolli i vitit 2022, i cili duket se është ndërtuar për nevojat e shfaqura rishtas përgjatë procesit të rivlerësimit dhe për të shpjeguar dhe argumentuar vlera të ndryshme të ndërtimit të objektit në funksion të mbështetjes së shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, duke përfaqësuar në vetvete një kontradiktë në shpjegimet që ai ka dhënë përgjatë hetimit administrativ në raport me deklaratat në deklaratat e pasurisë *vetting* dhe ato periodike.

**16.22.** Në vijim, trupi gjykues analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e z. G. D. si investitor i katit të fundit të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, veprim i cili synon që për efekt të analizës financiare subjekti të zhvishet nga kostot e ndërtimit të kësaj pjese të objektit. Sipas deklarimeve që subjekti ka bërë në deklaratat vjetore periodike,

---

<sup>25</sup> Përkufizimi i fjalës *situacion punimesh*, në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” përcaktohet: 18. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likuidim investitorit.

<sup>26</sup> Shënim i inxhinierit në aktin e konstatimit: “Bazuar në matjet faktike, fotove dhe ortofotove të periudhës përkatëse, çmimeve që i korrespondojnë punimeve respektive kur janë kryer është hartuar situacioni faktit i punimeve të kryera sa më lart”.

në ILDKPKI, pranë enteve/institucioneve të tjera, si dhe gjatë hetimit administrativ, lidhur me përfshirjen e z. G. D. në ndërtimin e katit të fundit të objektit, rezultojnë të dhënat si vijon.

**16.22.1.** Në deklaratën para fillimit të detyrës 2015, në DVP-të 2015 e 2016, edhe pse për objektin 3 kate + 1 kat papafingo ishte pajisur me leje ndërtimi, subjekti nuk deklaroi asnjë vlerë për investimet e kryera në këtë objekt, për pasojë, nuk deklaroi as përfshirjen si investitor të katit të fundit të z. G. D.. Po ashtu, në praktikën e miratimit të lejes së ndërtimit për këtë objekt, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të KRRT-së, Bashkia Kamëz, si aplikant për lejen e ndërtimit figuron vetëm subjekti i rivlerësimit.

**16.22.2.** Në funksion të saktësimit të kësaj mungese në deklaratim, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja (në datën 06.09.2016 dhe në datë 16.09.2016) dhe i është kërkuar të përcaktojë vlerën totale të investuar prej tij gjatë periudhës së ndërtimit, kohën kur ka filluar ndërtimi, pjesën e tij takuese, si dhe arsyet e mosdeklarimit të vlerës së këtij objekti. Në përgjigje të pyetjes nr. 5<sup>27</sup> të procesverbalit, datë 06.09.2016, të ILDKPKI-së, sërish subjekti i rivlerësimit nuk evidenton vlerën totale të investuar prej tij dhe as pjesën takuese, por vetëm informon se ky objekt është financuar me të ardhurat nga emigrimi në vitet 2000-2004 dhe sqaron se [...] *Kati papafingo nuk është ndërtuar pavarësisht se figuron në leje ndërtimi. Aktualisht banoj në katin e dytë, kati i përdhe është i pabanuar dhe i pashfrytëzuar (ndërtuar për biznes), kurse në katin e tretë banon dhëndri im pa detyrim për momentin.* Subjekti në vijim, më datë 16.09.2016, ka dorëzuar në ILDKPKI aktet: [...], lejen e ndërtimit, lejen e sheshit, vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të KRRT-së, Bashkia Kamëz, për miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe aktin e situacionit të punimeve hartuar në datën 15.09.2016 (1 ditë para dorëzimit të tij në ILDKPKI, i cituar më lart), i cili përmban, ndër të tjera, edhe shënimin se porosites i objektit 3 kate + 1 kat papafingo është z. Urim Buci pa asnjë gjurmë të emrit të z. G. D..

**16.22.3.** Në deklaratën *vetting*, e cila është dorëzuar nga subjekti më datë 26.01.2017 (rreth 4 muaj pasi ka dhënë në ILDKPKI deklaratimet e mësipërme), ai ka deklaruar: [...] *Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G. G. D., pasi ky shtetas është investori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G. D., i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh".* Vlera: 6.918.105 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: *Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.* Me dorëzimin e deklaratës *vetting* në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.,

---

<sup>27</sup> Përgjigja që subjekti ka dhënë për pyetjen nr. 5 të ILDKPKI-së është: *Objekti është ndërtuar si vazhdimësi e objekti të deklaruar në vitin 2005 dhe vlera e investuar nga emigracioni 2000-2004. Është në proces legalizimi (viti 2015) në emrin tim një pjesë e godinës, e cila është ndarë pothuaj në dy pjesë të barabarta, duke u bazuar në ndarjen e tokës prej 1.000 m<sup>2</sup> në dy pjesë të barabarta, pjesa tjetër ka leje ndërtimi. Vlera e investuar nuk është deklaruar për pamundësi llogaritjeje, pasi është ndërtuar nga vëllai, nuk është nxjerrë leja e shfrytëzimit dhe nuk është kryer akti i kolaudimit. Kati papafingo nuk është ndërtuar pavarësisht se figuron në leje ndërtimi. Aktualisht banoj në katin e dytë, kati i përdhe është i pabanuar dhe i pashfrytëzuar (ndërtuar për biznes) kurse në katin e tretë banon dhëndri im pa detyrim për momentin.*

datë 25.01.2017, të hartuar një ditë më parë, në të cilën subjekti deklaroi se z. G. D. është posedues, pasi është investitor i katit të 3-të të objektit me leje ndërtimi dhe objektit ekzistues.

**16.22.4.** Në fashikullin e krijuar nga ILDKPKI-ja gjenden të administruara, gjithashtu, edhe aktet: **(a)** vetëdeklarim i subjektit të rivlerësimit që mban datën 26.12.2014 (nr. {\*\*\*} prot., datë 07.01.2015, pranë ALUIZNI-t) dhe i referohet objektit 3 kate (150 m<sup>2</sup>) në adresën: rruga “{\*\*\*}”, Nr. {\*\*\*}, Kamëz, të ngritur në vitin 2006, për të cilin është kërkuar përfshirja në procedurat e legalizimit; **(b)** deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.01.2017, me deklaruues Urim H. Buci dhe G. G. D., në të cilën subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka deklaruar se mbi pasuritë e tij me nr. pasurie {\*\*\*} (toka me sip. 724 m<sup>2</sup>) dhe me nr. pasurie {\*\*\*} (toka me sip. 276 m<sup>2</sup>), është ndërtuar një objekt 3-katësh. Një pjesë e objektit është ndërtuar me leje ndërtimi, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të KRRT-së, Bashkia Kamëz, për një sipërfaqe ndërtimi 318 m<sup>2</sup> dhe se në ndryshim nga leja e dhënë nuk është ndërtuar papafingoja. Mbi këtë sipërfaqe prone, ngjitur me këtë objekt, është ndërtuar pa leje ndërtimi, por e vetëdeklaruar për legalizim referuar deklaratës nr. {\*\*\*}, datë 07.01.2015, një objekt 3-katësh, me sip. 50 m<sup>2</sup>/kat. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kati i tretë i dy objekteve është në posedim të dhëndrit të tij G. D., pasi ai është investitori i ndërtimit të katit të tretë të dy objekteve dhe të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të dy objekteve, përveç karabinasë, janë bërë nga dhëndri i tij. Ndërsa G. D. ka deklaruar se është dakord me sa është deklaruar më sipër, pasi ai ka ndërtuar dhe mobiluar katin e tretë të dy objekteve dhe aktualisht banon në këtë objekt.

**16.22.5.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, pasi shpjegon kronologjinë e ndërtimit të objektit me leje ndërtimi 3 kate + papafingo, deklaroi se vlera e objektit të investuar nga subjekti ka qenë në shumën 3.576.580 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 2.630.352 lekësh si e investuar nga G. D.. Për të provuar këtë deklaram/shpjegim të ri, i cili duket se tkurr vlerën e deklaruar si investim të kryer nga subjekti për këtë objekt në deklaratën *vetting*, subjekti paraqet si dokumentacion mbështetës aktin teknik të emërtuar “aktkonstatimi i punimeve” i datës 23.11.2022, i cituar dhe përshkruar më lart, në të cilin shfaqen si investitorë z. Urim Buci me vlerën totale të investuar prej 3.576.580 lekësh dhe z. G. D. me vlerën totale të investuar në shumën prej 2.191.960 lekësh.

**16.22.6.** Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit për të provuar angazhimin e z. G. D. si investitor të katit të fundit të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, përveç akteve të evidentuara në paragrafin 16.12 më sipër, ka paraqitur edhe deklaratën noteriale të datës 20.02.2015, në të cilën subjekti ka deklaruar se është dakord që kjo kontratë e lidhur midis tij dhe OShEE-së të lidhet midis OShEE-së dhe z. G. D., si dhe në fashikullin e hetimit administrativ gjendet kontrata për furnizimin me energji elektrike me nr. {\*\*\*}, me kod klienti {\*\*\*}, hapur më datë 20.04.2015 (për katin e parë banim).

**16.22.7.** Mbështetur në sa evidentuar më sipër, trupi gjykues konstaton se përlllogaritja e kryer nga Komisioni, duke ndarë veçmas pjesën e pretenduar si të investuar nga kunati i subjektit z. G. D. dhe veçmas pjesën e subjektit të rivlerësimit është një analizë që ka lënë jashtë konsiderimit deklaramin fillestar të subjektit në vitin 2015, si dhe shpjegimet e dhëna në ILDKPIK në shtator 2016. Z. G. D. është shfaqur si investitor në janar 2017 në deklaratën

*vetting*, edhe pse subjekti ka pasur rastin ta deklaronte atë që në deklaratën fillestare të vitit 2015 (pasi deklarata noteriale për lidhjen e kontratës së energjisë elektrike daton më 15.02.2015) ose ta deklaronte si investitor në ILDKPKI në shtator të vitit 2016, kur është ftuar të japë shpjegime mbi objektin e ndërtuar. Gjithashtu, kjo analizë e Komisionit rezultoi se nuk mbështetet as nga aktet e tjera të disponuara siç janë situacioni i punimeve dhe akti i konstatimit, të cilat nuk qëndrojnë në harmoni me njëra-tjetrën, pasi ato paraqesin një situatë të ndryshme që e vënë në diskutim si kohën e investimit<sup>28</sup> (për të cilën subjekti ka insistuar duke deklaruar se punimet janë kryer deri në vitin 2015), investitorët, po ashtu edhe vlerën e investuar në këtë objekt.

**16.23.** Për sa më sipër, nga trupi gjykues, *së pari*, konstatohet se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, mbi investimin në katin e tretë të kësaj godine nga kunati i tij, z. G. D., nuk provohen dhe nuk mbështeten nga dokumentacioni i administruar në dosjen që i përket kohës së pretenduar se është kryer investimi. Subjekti nuk ka deklaruar të drejtat e z. D. në deklarinimin para fillimit të detyrës në vitin 2015, në të cilin ka deklaruar se është pronar i vetëm i kësaj pasurie dhe as në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në shtator 2016, në të cilin ka deklaruar vetëm për të drejta përdorimi të z. D., pa detyrime, në momentin e deklarinimit. *Së dyti*, subjekti nuk ka deklaruar se z. D. është bashkëinvestitor i kësaj pasurie as në vetëdeklarimin që ai ka kryer pranë ALUIZNI-t në datën 27.12.2014, në të cilin, po ashtu, ka deklaruar se ai është pronari i kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit deklaroi pranë këtij institucioni rreth këtyre të drejtave vetëm në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.06.2018, pas depozitimit të deklaratës *vetting* dhe para se të dilte leja e legalizimit. Marrëdhëniet e z. D. me furnizuesit e energjisë elektrike dhe ujë të banesës konfirmojnë vetëm faktin e përdorimit të një pjese të saj, fakt që është deklaruar edhe prej subjektit në ILDKPKI në shtator të vitit 2016, por jo investimin apo pronësinë e tij mbi këtë objekt.

**16.24.** Në përmbledhje të analizës të të dhënave të pasqyruara më sipër, trupi gjykues konstatoi deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit edhe për vlerën e godinës 3 kate, (me leje ndërtimi). Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar për herë të parë se vlera e kësaj pasurie është 6.918.105 lekë dhe se pjesa takuese e tij është 100% e saj. Subjekti ka modifikuar përgjatë hetimit administrativ pjesën e tij takuese mbi këtë vlerë duke pretenduar se ai zotëron vetëm vlerën korresponduese të dy kateve të investuara prej tij që kapin shumën prej 3.576.580 lekësh, ndërsa pjesa tjetër i takon vlerës së objektit që është investuar prej kunatit të tij. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti ka modifikuar edhe shpjegimet përreth fazave të ndërtimit të objektit dhe investimit të tij në raport me kunatin, z. D., në secilën fazë ndërtimore. Konstatohen kontradikta edhe për sa i përket kohës së ndërtimit të kësaj pasurie, e cila fillimisht deklarohet si e përfunduar e më pas jo si e tillë, si dhe e përfshirjes së investimit të kunatit në ndërtimin e katit të tretë, pasi ai ishte ndërtuar si karabina prej subjektit. Sikurse është arsyetuar më sipër, rezultoi se dy akte teknike dhe një situacion punimesh i vitit 2016, që i referohet një objekti të papërfunduar, përcaktojnë si vlerë ndërtimore të tij vlerën prej 6.918.105 lekësh të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, dhe një aktkonstatim i vitit 2022, i hartuar nga i njëjti individ/ekspert, përcakton të njëjtën

---

<sup>28</sup> Akti i konstatimit përfshin punime të kryera dhe pas vitit 2016, sipas pretendimit të subjektit.

vlerë të objektit në këtë vit, duke përshkruar tashmë një objekt të përfunduar plotësisht. Mbi këto shpjegime, Komisioni ka përlogaritur vlerën e ndërtimit të këtij objekti, sipas referimeve në standardet e Entit Kombëtar të Banesave, duke i zbritur vlerës së ndërtimit vlerën e TVSh-së, në kundërshtim me qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit.

**16.25.** Trupi gjykues, në funksion të një analize sa më të plotë të këtij shkak ankimi, vlerësoi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, vlerën e objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, duke aplikuar metodologjinë e përdoruar në çështjet e tjera të shqyrtuara në Kolegjin, për identifikimin e kostove të ndërtimeve. Në rastin konkret, trupi gjykues konsideroi se pjesa e objektit me leje ndërtimi (3 kate + 1 kat papafingo) është investuar/financuar nga subjekti i rivlerësimit dhe tek ajo nuk u përfshi vlera e objektit fillestar-ekzistues, të cilën subjekti në deklaratën e pasurisë të vitit 2004 (të dorëzuar në cilësinë si OPGj më datë 12.10.2005), ka deklaruar se është financuar me të ardhurat e siguruara nga vëllai në emigracion.

Trupi gjykues konstatoi se elementet e metodologjisë së aplikuar nga Komisioni në analizën për evidentimin e kostos së ndërtimit të objektit me leje ndërtimi “3 kate + 1 kat papafingo”, që duhet të merren në shqyrtim lidhen me: **(i)** qëndrimin e Komisionit për të përlogaritur volumin e punimeve të ndërtimit në fazë karabinaje në masën 44.4%, duke u mbështetur në marrëveshjen e datës 17.05.2006, midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve “Për përcaktimin e treguesve për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”, duke evidentuar në vendim se kjo është praktikë e Komisionit, po ashtu edhe e Kolegjit; **(ii)** qëndrimin e Komisionit, i cili ka aplikuar si kosto ndërtimi vlerat e identifikuara në Udhëzimet e Entit Kombëtar të Banesave (EKB) për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave për vitet 2008-2009-2010 dhe për vitin 2015; **(iii)** qëndrimin e Komisioni, sipas së cilit vlera e objektit, sipas çmimeve të mësipërme të EKB -së, është reduktuar në masën 25%, për shkak të aplikimit të zbritjes të vlerës së TVSh-së dhe të fitimit, meqenëse, sipas subjektit, objekti është ndërtuar nga vetë familjarët.

**16.26.** Lidhur me elementet e mësipërm të analizës së kryer nga Komisioni për identifikimin e kostove të ndërtimit të objektit me leje 3 kate + 1 kat papafingo, trupi gjykues analizon sa vijon.

**16.26.1.** Për sa i përket volumit të ndërtimit të një objekti në fazën e karabinasë, trupi gjykues çmon se në këtë rast, në mungesë të një standardi ligjor të mirëpërcaktuar, në zbatim të parimeve të sigurisë juridike e barazisë para ligjit, do të duhet të aplikohen të njëjtat rregulla që janë zbatuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>29</sup>, në të cilën është përcaktuar se volumi i punimeve që konsiderohet në fazë karabinaje duhet të jenë në masën 42 % të vlerës së objektit dhe pjesa e mbetur prej 58% si volum punimesh për përfundimin e tyre.

**16.26.2.** Lidhur me aplikimin në rastin objekt analize të kostove të ndërtimit, vihet re se për periudhën 2008-2010, kur është konsideruar se janë kryer punimet e karabinasë, Komisioni ka përdorur çmimin 33.174 lekë/m<sup>2</sup>, që i korrespondon çmimit për sipërfaqe shfrytëzimi, që është një vlerë më e madhe se çmimi për sipërfaqe ndërtimi, ndërsa për vitin 2015 ka konsideruar çmimin 32.113 lekë/m<sup>2</sup> që i korrespondon çmimit për sipërfaqe ndërtimi.

---

<sup>29</sup> Vendimi i Kolegjit (JR) 34/2022, paragrafi 15.2.

Meqenëse sipërfaqet e marra në konsideratë i referohen sipërfaqeve të ndërtimit, sipas të dhënave të certifikuara nga ALUIZNI, si në rastin e përllogaritjes së kostos për ndërtimin e karabinasë dhe për pjesën e koston për përfundimin e objektit, duhet të aplikohet i njëjti çmimi, ai i kostos për sipërfaqe ndërtimi. Kështu, për vitet 2008 dhe 2009<sup>30</sup>, çmimi për njësi për sipërfaqe ndërtimi sipas EKB-së për qytetin e Tiranës është 27.439 lekë dhe për vitin 2010<sup>31</sup> çmimi për njësi për sipërfaqe ndërtimi është 28.333 lekë. Çmimi mesatar që do të aplikohet në analizën e Kolegjit për periudhën 2008-2010 do të jetë 27.737 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa për vitin 2015 çmimi i aplikuar është 32.113 lekë/m<sup>2</sup>. Duke aplikuar këto vlera, kosto e përllogaritur nga Kolegji për ndërtimin e karabinasë do të rezultojë në një vlerë me të vogël se vlera e përllogaritur nga Komisioni.

**16.26.3.** Për sa i përket qëndrimit të Komisionit, për të reduktuar kostot e ndërtimit të objektit me vlerën e TVSh-së dhe të fitimit, trupi gjykues evidenton se siç vetë subjekti ka shpjeguar/deklaruar gjatë hetimit administrativ, por edhe në gjykim, pjesa “3 kate + 1 kat papafingo” është ndërtuar bazuar në lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.07.2008, të Bashkisë Kamëz, e cila ka të përcaktuar se shoqëria e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, do të kryej punimet për realizimin e këtij objekti. Gjithashtu, vetë shoqëria me situacionin e datës 15.09.2015, të firmosur nga ing. L. T. dhe nga drejtuesi teknik ing. Gj. M., certifikon punimet e kryera duke përfshirë vlerën e TVSh-së. Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se vlera e reduktuar nga ana e Komisionit prej 25% (TVSh dhe fitim) nuk duhet të aplikohet, pasi punimet nuk janë kryer nga vetë familjarët, por nga shoqëria e ndërtimit. Në këto kushte, përllogaritja e kostos së ndërtimit nga ana e Kolegjit është bërë me vlerë të plotë, pa reduktimin e vlerës së TVSh-së, fitimit apo të fondit rezervë, të cilat, sipas metodologjisë<sup>32</sup> së Kolegjit, janë zëra që janë aplikuar në raste të tjera të ngjashme.

**16.26.4.** Në funksion të analizës financiare, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni ka përllogaritur të ndara kostot e objektit pa leje ndërtimi nga kostot e shtesës anësore që i janë bërë objektit, duke marrë në konsideratë periudhën e deklaruar nga subjekti në Komision për realizimin e

---

<sup>30</sup> Udhëzimi nr. 1, datë 20.08.2008, “Për miratimin e Kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB i banesave për vitin 2008 është i njëjti si për vitin 2008 dhe për vitin 2009”.

<sup>31</sup> Udhëzimi nr. 3, datë 03.02.2008, “Për miratimin e Kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB i banesave për vitin 2010”.

<sup>32</sup> Metodologjia e Kolegjit për përllogaritjen e kostos së ndërtimit në rastet ku ndërtimet janë informale, mbështetet në udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të EKB-së, ku përcaktohet struktura dhe elementet përbërëse të vlerës së kostos së punimeve të ndërtimit, të cilat janë të kategorizuara në 3 kategori: shpenzimet e drejtpërdrejta, shpenzimet e përgjithshme, fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh).

Mbështetur në jurisprudencën e Kolegjit (Paragrafët 33, 34, 35 në vendimin nr. 15/2019, datë 17.07.2019, subjekti rivlerësimi D. Rr., Paragrafët 52-55 në vendimin nr. 7/2022, datë 29.03.2022, subjekti rivlerësimi S. K.), në rastet e ndërtimeve informale nga çmimi për metër katror, sipas kostos së përcaktuar prej EKB-së, do të zbriten vetëm vlerat që përfaqësojnë “Fitim + Fond rezervë”.

Referuar qëndrimit të Komisionit për reduktim të vlerës së TVSh, referuar nenit 1, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh) paguhet:

a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të tilla kushte nuk është i bazuar pretendimi i subjektit dhe qëndrimi i Komisionit për zbritjen nga shpenzimet të përqindjes së TVSh-së për mallrat e përdorura për këtë ndërtim, pasi ajo është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit ai i ka blerë materialet për ndërtimin e objekti. Në këto kushte, TVSh-ja nuk mund të reduktohet nga kosto e ndërtimit edhe pse ndërtimet mund të kenë qenë informale.

punimeve<sup>33</sup>, meqenëse subjekti në momentin e emërimit në funksionin e prokurorit në vitin 2015 ka deklaruar se ky objekt ka qenë i përfunduar<sup>34</sup>.

**16.26.5.** Në referim të deklaramëve të mësipërme, nga analizimi i vendimit të Komisionit objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se në përlllogaritjen e kostove të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, nuk janë përfshirë kostot e ndërtimit të objektit fillestar të ndërtuar deri në mars të vitit 2005, i cili është deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2005. Trupi gjykues konstaton se i gjithë vendimi i Komisionit ka pranuar të mirëqenë shpjegimet që subjekti ka dhënë për këtë objekt në DVP-në 2004 (të përshkruar si banesë 2-katëshe me sip. 150 m<sup>2</sup> e ndërtuar në vitin 1995 e pa hipotekuar), të cilën e ka deklaruar se e ka në pjesë takuese 50 % në bashkëpronësi me vëllain, me vlerë 10.000.000 lekë, me të ardhura të siguruara në emigrim nga vëllai. Nga të dhënat e hetimit administrativ, rezulton se Komisioni nuk ka administruar ndonjë dokumentacion tjetër përveç atij që subjekti ka paraqitur me shpjegimet e procesverbalit të datës 16.09.2015, në ILDKPKI, për të ardhurat e siguruara nga vëllai i subjektit në emigracion, madje ka pranuar shpjegimin e dhënë nga subjekti se vlera e pjesës së ndërtuar deri në mars të vitit 2005 ka qenë 10 milion lekë të vjetra dhe jo 10 milion lekë të reja, pasi ky ka qenë një lapsus në deklarinimin e tij fillestar. Subjekti i rivlerësimi edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj nuk paraqiti të dhëna të tjera lidhur me të ardhurat e siguruara nga vëllai i tij në emigracion në Greqi, madje ai ka shpjeguar se në vitin 2005 (kur ka dorëzuar DVP-në për vitin 2004) ka deklaruar me përafërsi vlerën dhe sipërfaqen e objektit deri në atë moment, pasi nuk ka pasur ndonjë dokument apo akt zyrtar të cilit mund t’i referohej, për më tepër kur kjo pjesë e ndërtimit nuk është krijuar apo investuar prej tij.

**16.27.** Në analizë të kësaj situate faktike, trupi gjykues evidenton se në kushtet kur siç ka deklaruar vetë subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 (dorëzuar në tetor të vitit 2005), ai ka pasur në zotërim 50 % të objektit ekzistues të financuar nga vëllai i tij, ai duhet të deklaronte këtë pjesë në deklaratën *vetting*, si vlerën e saj, ashtu edhe burimet e financimit

---

<sup>33</sup> Në drejtim të kohës së ndërtimit të objektit, Kolegji nga burime të hapura në internet siç është Google Earth u konstatua se objekti në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, nga fotot që kjo platformë ofron si ortofoto e muajit maj 2016, rezulton i ndërtuar sipas përshkrimit që jep situacioni i punimeve i datës 15.09.2016

<sup>34</sup> Metodologjia e aplikuar nga Kolegji, për të identifikuar kostot e ndërtimit të objekti 3 kate + papafingo në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, është si vijon: Koha e ndërtimit të objekti është marrë sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision; për kostot e ndërtimit janë aplikuar përkatësisht: (i) për fazën e karabinasë është aplikuar masa 42% e vlerës së kostos së ndërtimit të përcaktuar nga EKB në vitin përkatës; (ii) për plotësimin e objektit është aplikuar masa 58% e vlerës së kostos së ndërtimit të përcaktuar nga EKB në vitin përkatës për sipërfaqe ndërtimi nga të cilat janë identifikuar vlerat; - për vitin 2009 në vlerën 27.439 lekë/m<sup>2</sup>; për vitin 2015 çmimi i aplikuar është 32.113 lekë/m<sup>2</sup>; për vitet 2008-2010 çmimi mesatar i aplikuar për sipërfaqe është 27.737 lekë/m<sup>2</sup>; Kolegji, gjithashtu, duke iu referuar shpjegimeve që subjekti ka dhënë në përgjigjet e pyetësorit nr. 7, ka përfshirë në analizë edhe kostot e ndërtimit në fazë karabinaje të kafazit të shkallëve me sip. 10 m<sup>2</sup> si të ndërtuar në vitin 2010, e cila rezulton se nuk është përfshirë në përlllogaritjen e kostos së objektit të bërë nga Komisioni.

Mbi bazën e këtyre të dhënave, sipas vlerësimit të bërë në Kolegj, bazuar në metodologjinë/standardin e aplikuar në jurisprudencën e deritanishme për përcaktimin e kostos sipas çmimeve referuese të EKB-së përfshi TVSH-në, përderisa subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues bindës për vlerën e tij, kostoja e ndërtimit të këtij objekti, për të cilën subjekti duhet të justifikonte burimin e ligjshëm, sipas metodologjisë së Kolegjit, do të mund të ishte nga 12.657.848 lekë, nëse do të konsiderohej se i gjithë ndërtimi ishte në pronësi të tij ose 9.092.834 lekë, nëse kati i tretë i godinës i përkiste kumatit të tij dhe sipas metodologjisë së përdorur në Komision, nga 10.170.381 lekë ose 9.872.221 lekë për të njëjtat situata.

ose të shpjegonte se çfarë kishte ndryshuar në marrëdhënien me pjesën e tij takuese të deklaruar në vitin 2005. Nga analizimi i deklaratës *vetting*, rezulton se subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram lidhur me këtë pjesë takuese, tashmë të integruar në banesën 3-katëshe të deklaruar në pronësi të tij, dhe ky fakt nuk ka gjetur asnjë trajtim në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi. Në vijim të analizës, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimi, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në versionin që pranohet se pjesa e banesës ekzistuese të vitit 2005 i është dhuruar atij nga vëllai, kishte detyrimin për të provuar burimet e ligjshme të financimit të saj.

**16.28.** Analiza e mësipërme sillet në vëmendje në këtë vendim, në drejtim të vlerësimit të deklarimeve të paplota e kontradiktore të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën, kohën dhe burimet e financimit të objektit të marrë në shqyrtimi mbi ankimin e Komisioneres Publike, e cila tregon se vlera/kosto reale e ndërtimit të këtij objekti është edhe më e lartë se vlera 12.657.848 lekë e përlogaritur në Kolegj, tek e cila nuk është përfshirë kosto e ndërtimit ekzistues, pjesë e këtij objekti në vitin 2005 të pretenduar si të financuar nga vëllai i subjektit.

**16.29.** Trupi gjykues, përveç sa më sipër, konstatoi se subjekti nuk ka shpjeguar qartë dhe as Komisioni nuk ka identifikuar vlerën e pjesës së ndërtesës së deklaruar të ndërtuar nga vëllai i subjektit dhe që është bërë pjesë integrale e godinës me tre kate që zotëron subjekti, duke mbetur kjo pjesë jashtë përlogaritjes së vlerës së përgjithshme të kësaj godine.

**16.30.** Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi deklaramet kontradiktore të subjektit, arriti në konkluzione të ndryshme për vlerën e ndërtimit të kësaj godine në varësi të disa elementëve që u konsideruan në mënyra alternative, si përfshirja ose jo në investim e z. D., përfshirja e TVSh-së dhe fondit rezervë, si dhe përlogaritja me çmim referues të EKB-së për sipërfaqe ndërtimi apo shfrytëzimi. Sipas vlerësimit të bërë në Kolegj, bazuar në metodologjinë/standardin e aplikuar në jurisprudencën e deritanishme për përcaktimin e koston, sipas çmimeve referuese të EKB-së përfshi TVSh-në, përderisa subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues bindës për vlerën e tij, kostoja e ndërtimit të këtij objekti, për të cilën subjekti duhet të justifikonte burimin e ligjshëm, sipas metodologjisë së Kolegjit, do të mund të ishte nga 12.657.848 lekë, nëse do të konsiderohej se i gjithë ndërtimi ishte në pronësi të tij ose 9.092.834 lekë, nëse kati i tretë i godinës i përkiste kunatit të tij, dhe sipas metodologjisë së përdorur në Komision, nga 10.170.381 lekë ose 9.872.221 lekë për të njëjtat situata. Nuk përfshihet në këtë llogaritje vlera e objektit të ndërtuar nga vëllai i tij dhe të zotëruar prej subjektit, e cila do të rriste sërish këtë kosto. Në secilin variant, për të cilin trupi gjykues nuk do të marrë një qëndrim përfundimtar edhe për shkak të mospasjes së një kërkimi në ankim, gjithsesi, vlera e objektit, për të cilën subjekti do të duhej të provonte burimet e ligjshme për krijimin, do të ishte më e lartë se ajo prej 7.514.635 lekësh që ka konkluduar Komisioni.

**16.31.** Në vijim, trupi gjykues, lidhur me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të ndryshme për burimet e financimit të përdorura për ndërtimin e këtij objekti, analizon sa vijon.



**16.32.** Nga deklaratimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratimet vjetore periodike, në deklaratën *vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit, përveç mospërputhjeve të mësipërme për vlerën dhe pjesën takuese në objektin në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka bërë deklaratime në versioneve të ndryshme për burimet e financimit të këtij objekti, përkatësisht si vijojnë.

**16.32.1.** Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit që subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare në vlerën totale të investimit të kryer prej 7.514.635 lekësh, pasi nuk arriti të provojë të ardhurat nga emigracioni, të cilat i ka deklaruar si burim për këtë ndërtim.

**16.32.2.** Subjekti, në konkluzion të shpjegimeve të dhëna për godinën e banimit, ka theksuar se kjo është një pasuri faktike e krijuar para detyrës së tij si prokuror dhe nuk afektohet nga interesat e mundshme të krijuara gjatë detyrës së prokurorit, gjatë së cilës ai ka qenë subjekt deklarues. Gjithashtu, subjekti, në vijim të prapësimeve të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se *të ardhurat e siguruara në shtetin anglez kanë qenë përafërsisht të paktën në shumën 60.000 GBP, për periudhën 4-vjeçare, duke rezultuar me një të ardhur mujore prej gati 1250 GBP. Sigurisht që kursimet kanë qenë dhe më pak. Pjesa e investuar nga ana ime është financuar kryesisht nga emigracioni, por nuk mund të përjashtoj edhe të ardhurat e siguruara gjatë punësimit tim dhe të bashkëshortes sime.*

**16.32.3.** Komisioni ka kryer një analizë financiare të *cash*-it dhe për periudhën para detyrës, (periudhës korrik 2005 - tetor 2015), ku ka rezultuar një diferencë pozitive në shumën 2.519.384 lekë.

**16.32.4.** Lidhur me mosdeklarimin e posedimit të “likuiditeteve në *cash*” në deklaratën e parë të dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit në Kolegj parashtroi se siç ka shpjeguar edhe në Komision në vitin 2008 paratë e kursyera nga nëna e tij, me burim të ardhurat e dërguara nga subjekti në emigracion, janë përdorur për objektin për të cilin është marrë leja e ndërtimit nga Bashkia Kamëz.

**16.33.** Lidhur me këto qëndrime/shpjegime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, të përsëritura prej tij edhe në Kolegj, trupi gjykues konstaton se subjekti ka tentuar të shtojë burime të tjera financimi për këtë objekt, në mesin e të ardhurave nga emigracioni, të cilat ai i identifikon në deklaratën *vetting*, si të vetmin burim financimi për këtë pasuri. Konkretisht, subjekti tenton të përfshijë si burime financimi për ndërtimin edhe diferencat e lira që i dalin nga analiza financiare e Komisionit, mbi mundësinë e tij për kursim në periudhën 2005-2015, duke përdorur në këtë rast argumentin se gjatë kësaj periudhe ai nuk ka pasur detyrimin për deklaram të pasurisë.

**16.34.** Gjithashtu, trupi gjykues vëren se nga analizimi i shpjegimeve, që subjekti ka dhënë gjatë hetimit administrativ për burimet e financimit të objektit, rezulton se ai tenton të evidentojë se të ardhurat nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar kanë qenë 60.000 GBP dhe se prej tyre ka kursyer shumën 30.000 GBP. Më tej, subjekti, me shpjegimin se *duke*

*përfshirë te të ardhurat nga emigracioni një shumë prej 30.000 GBP<sup>35</sup>, rezulton që analiza financiare për periudhën përpara fillimit të detyrës të jetë me një balancë pozitive në shumën 2.871.163 lekë, synon të përfshijë në analizën e burimeve të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, përveç shumës 30.000 GBP me burim nga emigracioni, edhe mundësinë për kursim që ka pasur nga pagat ndër vite, të evidentuar më sipër.*

**16.35.** Nga sa përshkruar më lart, trupi gjykues vlerëson se burimet e financimit të përmendura prej subjektit përgjatë hetimit administrativ, në rrethanat e vështirësisë për të provuar burimet e krijimit të deklaruar për këtë pasuri në deklaratën *vetting*, por edhe atë para fillimit të detyrës, si “prej emigracionit”, nuk arrijnë nivel besueshmërie, duke qenë se konstatohen si nevojë e përmbysjes së rezultatit të mundshëm negativ dhe jo një deklaram i vullnetshëm dhe që i përgjigjet të vërtetës. Për më tepër, këto shpjegime kontribuojnë në vlerësimin si të pabesueshme të deklarimeve që subjekti bën në tërësi për banesën gjatë hetimit administrativ, duke modifikuar deklaramet e shpjegimet e tij, sipas nevojave të evidentuara nga hetimi dhe jo si riprodhim i të vërtetës jetësore, mbi të cilën subjekti duhej të mbështeste vërtetësinë e deklarimeve të tij, krahas justifikimit të burimeve të përdorura për krijimin e pasurisë.

**16.36.** Në vijim të analizës, nga kontrolli i deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratën *vetting*, trupi gjykues konstaton se prej tij në rubrikën e deklaramit të të ardhurave subjekti nuk ka deklaruar të ardhurat e siguruara nga punësimi i tij në Mbretërinë e Bashkuar. Ky element përforcon konsideratën se përcaktimi i shumës 60.000 GBP me burim nga punësimi i subjektit në Mbretërinë e Bashkuar është deklaruar vetëm në funksion të mbulimit të kostove të ndërtimit të objektit të deklaruara si të tilla nga vetë subjekti në ILDKPKI në shtator të vitit 2016.

**16.37.** Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit lidhur me këto pasuri, arriti në konkluzionin se në kundërshtim me detyrimin kushtetues të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 e 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta e të paplota, si dhe ka mbajtur qëndrime kontradiktore për të dhënat e deklaruara rreth pasurive të mësipërme, të cilat e bëjnë të pamundur kontrollin e plotë lidhur me to.

- 17.** *Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike se për pasurinë tokë arë me sipërfaqe totale 1.000 m<sup>2</sup>, në Kamëz, Tiranë, të blerë më datë 26.07.2007, si dhe për objektin banesë 3 kate + papafingo, në rrugën “{\*\*\*}”, Kamëz, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhurat e deklaruara me burim nga emigracioni i tij në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 2000-2004, që kanë shërbyer për financimin e këtyre pasurive, si për sa i përket përfitimit, ashtu edhe ligjshmërisë të tyre, për të cilin trupi gjykues analizon sa vijon.*

---

<sup>35</sup> Shifra prej 12.657.848 lekësh e përlllogaritur nga Kolegji si kosto e ndërtimit të objektit nga vetë subjekti i rivlerësimit, konvertuar me kurset e këmbimit të monedhës GBP në lekë, në vitet kur ka ndodhur investimi është ekuivalente me rreth 72.792.36 GBP, vlerë e cila është më e madhe se shuma prej 30.000 GBP e deklaruar nga subjekti si e krijuar nga emigracioni.

17.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, është analizuar dhe konkluduar se duket se subjekti për periudhën para fillimit të detyrës (deri më 31.10.2015) rezulton me pamundësi financiare me vlerë prej 6.427.592 lekësh dhe për periudhën nëntor 2015 - 2016 (pasi është emëruar prokuror), rezulton me vlerë negative prej 745.142 lekësh. Kjo balancë negative e pranuar prej Komisionit është vlerësuar prej tij si proporcionale dhe, për pasojë, subjekti ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë duke argumentuar, ndër të tjera, se: [...] Kjo balancë negative vjen për shkak të mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga emigracioni para detyrës, të cilat kanë qenë burim krijimi për ndërtimin e objektit-pasurisë nr. {\*\*\*}, të analizuar nga Komisioni më lart. Vlerësimi i trupës gjyquese dhe analizimi i vlerës negative të analizës financiare para detyrës është trajtuar me analizën e burimit të krijimit të pasurisë nr. {\*\*\*}, si më lart [...].

17.2. Komisionerja Publike lidhur me këtë konkluzion ka pretenduar se: Për sa i përket ligjshmërisë së burimeve të përdorura për investimin në godinën e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo, të analizuar në të gjitha variantet e deklaruara nga ana e subjektit, rezulton se ky i fundit nuk arrin të provojë ligjshmërinë e burimeve të pretenduara si të ardhura nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar. Aktet e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, fotografi dhe deklarimi i tij në formularin e dekriminalizimit, dorëzuar pranë organeve përgjegjëse, nuk provojnë as masën e të ardhurave të krijuara dhe as ligjshmërinë e tyre, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Kolegjit. Komisionerja Publike sjell në vëmendje këtu dhe mosdeklarimin nga ana e subjektit të posedimit të kursimeve në "likuiditete në cash" 2005, në pozicionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

17.3. Me qëllim shqyrtimin e plotë të këtij shkakut ankimi, trupi gjyqësor në referim të konkluzioneve të mësipërme, lidhur me vlerën e objektit në rrugën "{\*\*\*}", në Kamëz, Tiranë, u ndal në verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e truallit në të cilin është ndërtuar ky objekt, si dhe ndërtimin e pjesës me leje ndërtimi 3 kate + 1 kat papafingo. Për këtë qëllim, u morën në analizë deklaratimet e bëra nga subjekti për burimin e të ardhurave në deklaratën vetting, në DVP-të, në ILDKPKI, gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, duke konstatuar sa vijon.

17.3.1. Në deklaratën para fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se banon në rrugën "{\*\*\*}", Kamëz, Tiranë dhe në rubrikën e deklaratimit të pasurive dhe të burimit të krijimit të kësaj deklarate, ai deklaron se disponon pasuritë e paluajtshme:

1. Tokë arë me sipërfaqe 724 m<sup>2</sup>, [...] Burimi i krijimit: Të ardhura këto të siguruara nga emigracioni, përkatësisht unë deklaruesi në Angli (2000 – 2004) dhe vëllai D. B. në Greqi (1991 – 2012).

2. Tokë arë me sipërfaqe 276 m<sup>2</sup>, [...]. Burimi i krijimit: Të ardhura këto të siguruara nga emigracioni, përkatësisht unë deklaruesi në Angli dhe vëllai në Greqi.

3. Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo, [...]. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.

17.3.2. Në DVP-në 2015, subjekti i rivlerësimit nuk bën asnjë deklaram tjetër lidhur me pasuritë e paluajtshme të ndryshme nga ato të deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2015.

17.3.3. Në deklaratën *vetting*, për pasuritë tokë arë, subjekti i rivlerësimit bën të njëjtin deklaram si në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, ndërsa për objektin në rrugën {\*\*\*}, Kamëz, Tiranë, deklararon se: [...] *Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G. D., pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G. D., i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh. Vlera: 6.918.105 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruuesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.*

17.4. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaramet periodike të pasurisë dhe në deklaratën e *vetting* ka identifikuar si burime financimi për blerjen e tokës, mbi të cilin ndodhet ky objekt, të ardhurat nga emigrimi i vëllait, pa dhënë vlerën e saktë të investuar prej tij, ndërsa për ndërtimin e objektit ka deklaruar se vlera e investimit është 6.918.105 lekë. Pjesa takuese: 100% dhe burimi i krijimit: *të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruuesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.*

17.5. Nga analizimi i deklaramit të subjektit në vitin 2005, trupi gjykues konstaton se prej tij nuk është deklaruar disponimi i kursimeve nga emigracioni, nga i cili subjekti ishte kthyer në vitin 2004. Gjithashtu, edhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, subjekti nuk ka deklaruar pjesën apo shumën e të ardhurave që ka krijuar në emigracion e që kanë shërbyer për financimin e objektit. Në këtë drejtim, trupi gjykues, siç ka evidentuar edhe më sipër, konstaton se në deklaratën *vetting*, në rubrikën e deklaramit të të ardhurave, subjekti nuk ka deklaruar vlerën e të ardhurave të siguruara nga punësimi i tij në Angli.

17.6. Në vijim të konstatimeve të mësipërme, duke konsideruar deklaramin për burimin e financimit të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë dhe të blerjes së truallit nën të, në kushtet kur burimi i deklaruar në deklaratën *vetting* nuk lë vend për përfshirje të burimeve të tjera, trupi gjykues çmon se analiza duhet të përqendrohet në provueshmërinë e ekzistencës së të ardhurave nga emigracioni dhe të burimit të ligjshëm të krijimit të tyre.

17.7. Lidhur me ekzistencën e të ardhurave nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioni gjatë hetimit administrativ i ka kërkuar subjektit i rivlerësimit të japë shpjegime mbi aktivitetin fitimprurës në këtë vend përgjatë viteve 2000-2004, për të cilat ai ka shpjeguar përkatësisht:

(i) Me përgjigjet e dhëna në pyetësonin nr. 5, subjekti ka deklaruar se ka punuar në disa punë të ndryshme<sup>36</sup>, duke bërë një shpjegim narrativ të punës së kryer, adresat e punëdhënësve, pa shpjeguar lidhur me kohëzgjatjen dhe pagën e përfituar nga këto punësime.

---

<sup>36</sup> Në përgjigje të pyetësonit nr. 5, subjekti ka shpjeguar se:

(ii) Me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat e tij nga emigracioni të përfituara në shtetin anglez nga muaji nëntor 2000 - maj 2004 kanë qenë rreth 60 mijë GBP.

(iii) Në përgjigjet e pyetësorit nr. 8, si dhe në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se kursimet i ka dërguar pjesë-pjesë nëpërmjet Western Union, me nga 2 mijë GBP secila (aq sa ka qenë limiti i lejuar i çdo transferte), në total rreth 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) GBP, shuma të cilat i ka tërhequr z. H. B., i ndjeri babai i tij. Po ashtu, gjatë të njëjtës periudhë ka dërguar për familjen disa herë sipas rastit nga 5-6 mijë GBP, nëpërmjet shokëve që ishin me dokumente të rregullta, shuma të cilat i janë dorëzuar nënës së tij M. B., pasi në atë periudhë vëllai D. B. kishte probleme shëndetësore dhe i ndjeri babai i tij ishte i sëmurë.

17.8. Me qëllim provueshmërinë e transferimeve të shumave monetare, të kryera me Western Union nga Mbretëria e Bashkuar drejt familjes së origjinës, subjekti i është drejtuar me një kërkesë Western Unionit Financiar në Tiranë dhe ka marrë përgjigje nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2023, në të cilën është konfirmuar se nuk i disponojnë aktualisht të dhënat për transferuat e kryera nga subjekti, duke shpjeguar se: *“Të dhënat personale të klientëve mbahen deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare me klientin. Në përfundim të periudhës pesëvjeçare banka fshin këto të dhëna nga skedarët dhe nga sistemi kompjuterik dhe fizik bankar”*. Subjekti, si në Komision, ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, ka pretenduar se gjatë viteve 2000-2004 ka qenë emigrant në Angli në mënyrë informale, pa leje qëndrimi/pa leje pune dhe, në këtë këndvështrim ka qenë në pamundësi objektive për deklarimin e këtyre të ardhurave si individ në atë shtet e, për rrjedhojë, as për kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore përkatëse lidhur me to. Sipas subjektit, fakti që ai ka qenë në emigracion rezulton të jetë deklaruar prej tij edhe në formularin e dekriminalizimit të depozituar për efekt të ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*. Sipas subjektit, janë bërë përpjekje maksimale për kërkimin e provave mbi ekzistencën e vlerave monetare të disponuara prej tij në atë periudhë, por për shkak të kohës së gjatë ka qenë e pamundur për të siguruar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, por gjithsesi këto të ardhura janë investuar në ndërtimin e shtëpisë.

17.9. Lidhur me të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion në Angli, edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ashtu siç ka deklaruar edhe në Komision gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 2 e nenit 32 e ligjit nr. 84/2016, për të dokumentuar të ardhurat në emigracion. Në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtroi se për sa i takon legjitimitetit të të ardhurave nga emigracioni ai nuk mund të penalizohet duke mos iu konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm, në kushtet kur mospagimi i detyrimeve

- 
- a) *Fillimisht ka punuar për një periudhë rreth 6 muaj së bashku me djalin e dajës, shtetasin B. M. në një fabrikë prodhimi pajisjesh elektrike alumini me emrin “{\*\*\*} LTD në adresën: {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, England (UK).*
  - b) *Më pas ka punuar si ndihmës kuzhinier dhe shitës njëkohësisht në një “{\*\*\*} (aktualisht {\*\*\*}) së bashku me shtetasin H. D., i njohur nga zona e lindjes në adresë: {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*} England (UK).*
  - c) *Më pas ka punuar si kamerier në dy restorante italiane, njëri me emrin {\*\*\*} (aktualisht {\*\*\*}) së bashku me djalin e dajës B. M., shtetasin A. D. i njohur nga zona e lindjes, shtetasin H. L. nga Dibra dhe shtetasin A. L. nga Shkodra në adresë: {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}, England (UK).*
  - d) *Restoranti tjetër me emrin {\*\*\*} (aktualisht {\*\*\*}) së bashku me shtetasin H. L. nga Dibra në adresë: {\*\*\*}, {\*\*\*} England (UK).*

tatimore nuk ka qenë për faj të tij, pasi ai ka qenë në mirëbesim. Gjithashtu, subjekti evidentoi se për shkak të pagimit të detyrimeve tatimore jurisprudenca e Kolegjit ka evoluar duke marrë në konsideratë edhe rrethanat konkrete që kanë shkaktuar mospagimin e detyrimeve tatimore.

17.10. Në fashikullin e hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit lidhur me ardhurat nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar ka depozituar disa akte<sup>37</sup> nga analizimi i të cilave evidentohet se janë kryesisht deklarata noteriale të të njohurve/miqve të subjektit, të cilët deklarojnë mbi periudhën e punësimit, adresat dhe punën e kryer nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 2000-2004, por këto të dhëna mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe nuk kënaqin/përmbushin kërkesat e ligjit në drejtim të ligjshmërisë së të ardhurave. Në drejtim të vlerësimit të këtyre akteve silltet në vëmendje jurisprudenca e Kolegjit, sipas së cilës vlera provuese e deklaratave noteriale të lëshuara përgjatë procesit të rivlerësimit, në kushtet kur ato janë të vetme e të pambështetura nga akte të tjera, është e kufizuar dhe nuk krijon besueshmëri për ekzistencën e fakteve të deklaruara në to.

17.11. Në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së të ardhurave nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit në përgjigjet për pyetësonin nr. 8, ka shpjeguar në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes së *cash*-it në deklaratimet fillestare të vitit 2005 e 2015, duke argumentuar se në vitin 2008, kur mora lejen e ndërtimit për të ndërtuar shtëpinë “godinë e kombinuar 3-kat”, nëna ime M. Sh. B. kishte ruajtur një pjesë të këtyre parave pa më treguar më parë për këtë dhe mi ka dhënë për të ndërtuar shtëpinë. Kjo është dhe arsyeja që këto para nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2005, pasi ato nuk disponoheshin prej meje, por prej nënës sime në ekonominë familjarë. Në vijim të sa konstatuar më sipër, edhe ky shpjegim i subjektit, jo vetëm mbetet në nivel deklarativ dhe nuk provon shumën e disponuar dhe as ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, por rezulton edhe i bërë prezent në një fazë të avancuar të procesit, vetëm në përgjigje të pyetjeve të drejtuara në pyetësonin nr. 8, ndërsa procesi hetimor interaktiv mes tij dhe Komisionit zhvillohej tashmë prej kohësh mes një korrespondence të dendur pyetje-përgjigjesh e përcjellje dokumentacioni. Këtij arsyetimi i bashkëngjitet fakti se në deklaratën *vetting*, në të cilën subjekti ishte thirrur për të deklaruar nën përgjegjësi të ardhurat dhe pasuritë e

---

<sup>37</sup> Dokumentet provuese të përcjella nga subjekti me prapësimet e rezultateve të hetimit janë si vijon:

- (i) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2023, me deklarues shtetasin A. D.;
- (ii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2023, me deklarues shtetasin H. D.;
- (iii) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2023, me deklarues shtetasin G. D.;
- (iv) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2023, me deklaruese shtetasen M. B.;
- (v) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 19.04.2023, me deklarues shtetasin D. B.;
- (vi) librezë personale shëndeti nr. regjistri {\*\*\*}, e D. B., në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe;
- (vii) leje qëndrimi, datë 23.06.2000, e D. B., në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe, vërtetuar përkthimi me nr. {\*\*\*}, datë 14.04.2023;
- (viii) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2023, nga Union Financiar Tiranë;
- (ix) deklaratë noteriale, datë 13.04.2023, me deklarues shtetasin B. M., në gjuhën angleze, përkthyer në gjuhën shqipe; vërtetim përkthimi nr. {\*\*\*} rep., datë 18.04.2023;
- (x) deklaratë noteriale, datë 13.04.2023, me deklarues shtetasin A. L., në gjuhën angleze, përkthyer në gjuhën shqipe + vërtetim përkthimi nr. {\*\*\*} rep., datë 18.04.2023, të shtetasit A. L.;
- (xi) një zarf (PostPak), i cili është dërguar nga unë në datën 13.02.2004, prej shtetit të Anglisë, nëpërmjet Royal Mail, në adresë të pritësit, bashkëshortes time S. B. (F.), në atë kohë të fejuar;
- (xii) 13- fotografi të realizuara në shtetin anglez gjatë vitit 2000-2004.

krijuara me to, sërish mungon deklarim i tij për të ardhurat e krijuara në emigracion, qoftë edhe në vlerën e deklaruar, por të paprovuar prej subjektit. Mungesat e deklarimeve në secilin akt e fazë të procesit rreth të ardhurave të krijuara në emigracion, vlerës së tyre, mënyrës së disponimit, aq më tepër kur ato kanë shërbyer për të krijuar pasuri, vlerësohet si një element i rëndësishëm që cenon besueshmërinë e deklarimeve të subjektit rreth tyre në faza të ndryshme të procesit, kur ftohet për ta bërë këtë si një nevojë e shpjegimit të burimeve të përdorura për krijimin e pasurisë. Mungesa e besueshmërisë në deklarimet për mënyrën e krijimit të këtyre të ardhurave, masës, vendit e kohës, vlerësohet në harmoni me paprovueshmërinë e dokumentimin e tyre, si dhe pa plotësinë e kriterëve kushtetues e ligjorë për të ardhurën e ligjshme, duke e bërë të pamundur aplikimin e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë që zbatohet në një kontekst krejt të ndryshëm rrethanash objektive. Gjithashtu, trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit<sup>38</sup>, lidhur me mungesën e deklarimit të gjendjeve *cash* në deklaratat periodike, e cila në këtë rast vlerësohet si një e dhënë më shumë që afekton besueshmërinë e krijimit të të ardhurave në emigracion dhe ekzistencën e tyre në vlerat e pretenduara në fund të procesit, si një gjendje *cash* e poseduar prej nënës së subjektit.

**17.12.** Në përfundim të analizimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, *së pari*, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhurat e krijuara nga emigracioni në rubrikën e dedikuar kësaj kategorie, në asnjë formë, por vetëm i ka përmendur ato si burim për krijimin e pasurive. Ai ka dhënë një shifër të përafërt të tyre për herë të parë, në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 7, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ka dështuar të paraqesë prova që provojnë marrëdhënien e punësimit, si dhe përfitimin e tyre, ndërsa ka pohuar se ka qenë i punësuar i pa pajisur me dokumentacion, për pasojë nuk mund të provonte pagimin e detyrimeve tatimore, si një kriter kualifikues për standardin e të ardhurës së ligjshme, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. *Së dyti*, përveç mungesës së provueshmërisë së tyre, trupi gjykues ka në konsideratë edhe faktin që subjekti ka demonstruar paqartësi për ekzistencën dhe vlerën e tyre, duke qenë se nuk i ka përcaktuar ato në përputhje me detyrimet që i vinin, jo vetëm nga ligji nr. 84/2016, por edhe nga detyrimet e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, i ndryshuar, kur ai ka kryer deklarimin e parë të pasurisë të dorëzuar në vitin 2005 si oficer i policisë gjyqësore, por edhe në vitin 2015 përpara fillimit të detyrës si prokuror, ndonëse i ka deklaruar ato si burim për krijimin e pasurive të tij. Shpjegimet mbi zotërimin e të ardhurave nga emigracioni, përgjatë periudhës 2008-2015, kur deklaroi se është ndërtuar godina, për shkak të administrimit të tyre nga nëna e tij, vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 8, gati në fazën përmbyllëse të hetimit administrativ, vlerësohen prej trupës se mbeten në nivel deklarativ dhe nuk ishin bindëse qoftë edhe për ekzistencën e tyre.

**17.13.** Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisioneren Publike se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e pretenduara prej emigracionit, jo vetëm në drejtim të ligjshmërisë, por edhe në drejtim të vetë ekzistencës së tyre, për shkak edhe të deklarimeve të tij të paplota e të pasakta, duke u gjendur në çdo rast në mungesë të

---

<sup>38</sup> Shih vendimet e Kolegjit (JR) 7/2019 dhe (JR) 11/2019.

burimeve të ligjshme për të financuar krijimin e pasurive tokë arë dhe godinë në pronësi të tij, situatë e cila kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Trupi gjykues, gjithashtu, mori në shqyrtim edhe kërkimin e Komisioneres Publike, e cila pretendon *se në rastin konkret, duke konsideruar balancën negative të pranuar prej Komisionit, në vlerën prej (-) 7.514.635 lekësh për godinën dhe (-) 464.014 lekë në analizën financiare të vitit vitin 2016, referenca dhe arsyetimi i Komisionit, bazuar në parimin e “proporcionalitetit” apo atë të “objektivitetit”, për të mos aplikuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe jo plotësisht i justifikuar në normativën kushtetuese dhe atë ligjore.*

18.1. Komisioni në vendim, pasi ka konkluduar për mungesë të burime të ligjshme si më sipër, për një balancë totale negative në vlerën prej 7.978.649 lekësh, ka vlerësuar se ajo nuk mund të shërbejë për të ndëshkuar me masë disiplinore subjektin mbështetur në argumente si: **(i)** rrethanat faktike e vënë në vështirësi Komisionin të vlerësojë burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë të krijuar që prej vitit 1996, kur ai ishte student e deri në vitin 2015, kur ai është emëruar prokuror; **(ii)** të ardhurat janë krijuar në emigracion dhe pasuria është krijuar para se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit dhe ndonëse ai nuk gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sërish mosprovimi i tyre nuk vlerësohet si një element i rëndësishëm, që të justifikojë vendosjen e masës disiplinore; **(iii)** nuk ekziston ndonjë e dhënë që të bën të dyshosh se subjekti i rivlerësimit me deklarin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme; **(iv)** në vlerësim të argumenteve të mësipërm, në dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, si edhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>39</sup>, mungesa e burimeve e konkluduar prej Komisionit nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016

18.2. Komisionerja Publike në ankim, por edhe në parashtrimet gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, ka pretenduar *se në rastin konkret, referenca dhe arsyetimi i Komisionit, bazuar në parimin e “proporcionalitetit” apo atë të “objektivitetit”, për të mos aplikuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe jo plotësisht i justifikuar në normativën kushtetuese dhe atë ligjore [...].* Këto parime nuk mund të zbatohen në rastet kur konstatohen, jo vetëm një, por disa problematika domethënëse, parimi i proporcionalitetit nuk mund të shërbejë për anashkalimin e vetë qëllimit për të cilin është ngritur procesi i rivlerësimit dhe zbatimit korrekt të ligjit të posaçëm. Për pasojë, pamjaftueshmëria e konsiderueshme financiare e konstatuar nga mungesa e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo, në vlerën 7.514.635 lekë, pasaktësitë dhe deklarinet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, së bashku me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni për mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të për vitin 2016, në shumën – 464.014 lekë, të çojnë në situatën ligjore që subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të

<sup>39</sup> Vendimi nr. 6, datë 17.03.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.



*pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

Për sa më sipër, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e Komisioneres Publike për të çmuar në rastin objekt shqyrtimi, nëse është me vend që të gjejë zbatim parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit në raport me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara nga Komisioni

**18.3.** Për t'i dhënë zgjidhje çështjes së mësipërme, trupi gjykues mori në analizë konkluzionet lidhur me çështjet e analizuara më sipër në këtë vendim, vlerësimi i të cilave u krye në kontekstin e matjes së peshës që ato duhet të kenë në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke konstatuar sa vijon.

**18.3.1.** Siç është evidentuar edhe në sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk provon me asnjë formë krijimin e të ardhurave të pretenduara në emigracion, në drejtim të ekzistencës së tyre, vlerës, transferimit, si edhe të plotësimit të kriterëve të ligjshmërisë, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Në këtë kuptim i gjithë objekti rezulton i pa mbuluar me burime financiare të ligjshme, sipas kërkesave të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

**18.3.2.** Siç është konkluduar më sipër, subjekti ka bërë deklarime kontradiktore, të paplota e të pasakta, lidhur me pasurinë e vendosur në kontroll, në drejtim të vlerës, pjesës takuese, kohës së ndërtimit, si edhe investimit të kryer për ndërtimin e saj. Për rrjedhojë, këto kundërshti vënë në vështirësi organet e rivlerësimit për të realizuar një kontroll të plotë e për të arritur në përfundime të sakta rreth kësaj pasurie.

Sipas analizës së kryer në Kolegj mbi deklaratimet e subjektit, në përpjekjeje për një lexim logjik, kronologjik e interpretim ligjor të të dhënave të dokumenteve të administruara gjatë hetimit, kostot e ndërtimit të këtij objekti kanë rezultuar të kenë qenë edhe më të larta se shuma prej 7.514.635 lekësh e përcaktuar si kosto e këtij objekti në vendimin e Komisionit, në të cilën nuk është përfshirë kosto e ndërtimit të objektit ekzistues para vitit 2005 dhe as është përdorur metodologjia e Kolegjit për përcaktimin e kostove të ndërtimeve informale, si edhe është përfshirë si pjesë investimi/kontributi i z. G. D., ndonëse i pabesueshëm, për shkak të kontradiktoritetit të deklaratimeve.

**18.3.3.** Trupi gjykues, gjithashtu, evidenton faktin se vlera e përcaktuar për objektin në deklaratën *vetting* prej 6.9 milion lekësh nuk justifikohet me të ardhurat e deklaruara se janë kursyer nga subjekti prej atyre të deklaruara si të fituara në emigracion, edhe sikur të pranohej se ai ka krijuar në emigracion të gjitha të ardhurat e deklaruara. Subjekti ka ndryshuar vlerën e këtij investimi dhe ka shtuar burimet e krijimit përgjatë hetimit administrativ, pikërisht në rrethanat kur është bërë me dije nga Komisioni se të ardhurat e deklaruara si të krijuara në emigracion nuk janë të mjaftueshme për të krijuar pasurinë objekt kontrolli.

**18.3.4.** Trupi gjykues ka në konsideratë faktin se sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, kostot e ndërtimit të objektit mund të shkonin në shumën 12.657.848 lekë, e cila sigurisht që do të thellonte balancën negative të pranuar prej Komisionit. Shifrat e ndryshme të kostos së ndërtimit të objektit, në vlerësimin e trupit gjykues, e bëjnë të pamundur zbatimin e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për sa kohë që balanca negative e pranuar mund të jetë edhe shumë më e thellë.

**18.3.5.** Trupi gjykues, referimin në jurisprudencën e Kolegjit nga subjekti, e gjen të padrejtë për sa kohë që rasti i referuar përbëhet nga elementë të ndryshëm faktikë që lidhen, si me saktësinë e deklarimeve, provueshmërinë e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë së subjektit, pamundësinë e organeve tatimore për përcjelljen e informacionit, por edhe balancën negative me vlera disafish më vogla se balanca negative e rastit objekt shqyrtimi<sup>40</sup>, për pasojë ai nuk mund të shërbejë si një referencë për zgjidhjen e çështjes me analogji me atë objekt shqyrtimi.

**18.3.6.** Argumenti se pasuria e analizuar është krijuar para detyrës së prokurorit nuk vjen në harmoni me qëndrimet e mbajtura prej Kolegjit në rastet të tjera të ngjashme<sup>41</sup>, në të cilat edhe këto pasuri i janë nënshtruar analizës dhe kontrollit të burimeve të krijimit dhe subjektet janë ndëshkuar edhe për pasuri të krijuara para marrjes së detyrës së magjistratit, kur shkeljet e konstatuara janë konsideruar të pakapërcyeshme e të rëndësishme për vlerësimin e pasurive të tyre. Për më tepër që subjekti i rivlerësimit, ndonëse nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit në kohën e krijimit të pasurisë, ka qenë pjesë aktive e strukturës së prokurorisë duke qenë se ka ushtruar atributet e oficerit të policisë gjyqësore në seksionet e prokurorisë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Fier e Tiranë, duke përfaqësuar një subjekt procedural të rëndësishëm të procedimit penal, për pasojë të dhënies së drejtësisë penale.

**18.4.** Në përfundim të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se deklaramet kontradiktore të subjektit, lidhur me vlerën dhe burimet e krijimit të pasurisë apo edhe me të ardhurat e krijuara në emigracion, shpjegimet e dhëna përgjatë procesit të hetimit administrativ, jo në funksion të pasqyrimin me vërtetësi të rrethanave faktike, por edhe modifikimit të tyre në funksion të zvogëlimit të balancave negative dhe shmangies së konkluzioneve që mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin, të para në harmoni me situatën financiare që rezulton nga kontrolli i ushtruar për krijimin e dy pasurive, tokë arë dhe godinë, qoftë edhe për balancën negative të pranuar prej Komisionit, në total përafërsisht në vlerën prej 8.000.000 lekësh (7.514.635 lekë + 464.014 lekë = 7.978.649 lekë), nuk lejon thirrjen për zbatim të këtyre dy parimeve të rëndësishme të procesit të rivlerësimit.

**18.5.** Parimi i objektivitetit konsiderohet i pazbatueshëm prej trupit gjykues, sepse subjekti ka bërë të pamundur objektivisht, për shkak të deklarimeve kontradiktore dhe deklarimeve

---

<sup>40</sup> Në vendimin e Kolegjit (JR) 6/2022 balanca negative ka rezultuar në vlera ndjeshëm më e vogla dhe për të është arsyetuar si vijon:

*Krahas arsyetimit të mësipërm, Kolegji pati në konsideratë në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën disa rrethana, si: (i) informacionin e përcjellë prej organeve tatimore të cilat referojnë në mungesën e të dhënave lidhur me aktivitetin e subjektit për shkak të kohës së largët dhe mungesës së një databaze unike; (ii) faktin që subjekti i rivlerësimit e ka ndërprerë aktivitetin e avokatit në mënyrë përfundimtare në vitin 1998 dhe ka shkëputur çdo marrëdhënie të mëpasshme me këto organe në këtë cilësi; (iii) shumën e konstatuar si mungesë burimesh financiare për periudhën 1996-1997 në vlerën (-) 2.631.493 lekë në versionin se kostoja e ndërtimit do të konsiderohet në vlerën prej 3.517.464 lekësh ose (-) 2.401.766 lekë në versionin që kostoja e ndërtimit do të konsiderohet se është 3.205.493 lekë, e cila vjen edhe për shkak të një analize financiare mbi të dhëna të pranuar, por jo të dokumentuara në drejtim të provueshmërisë së kostove të ndërtimit; (iv) raportin në të cilin qëndron kjo shumë krahasuar me të ardhurat e pretenduara, faktin që në përcaktimin e kësaj balance negative janë konsideruar zero të ardhurat nga avokatia, element që nuk përfaqëson të vërtetën e arsyeshme sipas vlerësimit të Kolegjit, si edhe faktin se ajo i përket një pasurie që rezulton se është krijuar gjatë kohës që subjekti ushtronte profesionin e avokatit.*

<sup>41</sup> Shih vendimet e Kolegjit (JR) 2/2016, (JR) 12/2020 dhe (JR) 12/2022.

jo në përputhje me detyrimin ligjor, konstatimin e plotë e të saktë të situatës faktike, mbi të cilën organet e rivlerësimit duhet të bëjnë vlerësimin e pasurisë së tij. Siç u arsyetua më sipër, për shkak të këtyre deklarimeve, vlerësohet e pamundur të përcaktohet saktësisht vlera e ndërtimit, pjesa takuese e subjektit, si dhe burimet e përdorura për krijimin e tij, konkluzione që vënë seriozisht në diskutim konkluzionin e Komisionit për koston e ndërtimit dhe mungesën e burimeve të ligjshme.

**18.6.** Trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, se parimi i proporcionalitetit nuk lejon në këtë rast mosaplikimin e masës disiplinore, sepse balanca negative në vlerën e pranuar nga Komisioni prej përrreth 8.000.000 lekësh vlerësohet si një mungesë e rëndësishme, e cila cenon standardin kushtetues të provimit bindshëm të ligjshmërisë së pasurisë. Në këtë arsyetim, mbahet në konsideratë edhe fakti që dhe në versionin në të cilin subjekti do të provonte të ardhurat e tij të kursyera nga emigracioni në vlerën prej 30.000 GBP (përafërsisht<sup>42</sup> 5.220.000 lekë), sërish ai do të ishte në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive për një vlerë prej 2.780.000 lekësh, për të cilat nuk ka mundur të evidentojë/deklarojë asnjë burim të ligjshëm të njohur. Pretendimi i subjektit se ai e ka krijuar këtë pasuri para marrjes së detyrës nuk vlerësohet nga trupi gjykues se i shërben në mënyrë domethënëse situatës konkrete edhe për shkak të faktit se, ndonëse jo në detyrën e prokurorit, subjekti ka kryer funksionet e oficerit të policisë gjyqësore pranë seksioneve të prokurorisë, përgjatë gjithë kohës së krijimit të këtyre pasurive.

**18.7.** Në kushtet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi si të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike se mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, krahas deklarimeve kontradiktore e të pasakta, është e mjaftueshme për të konkluduar se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe duhet të gjejë vend zbatimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

- 19.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisioneres Publike, e cila ndryshe nga Komisioni vlerëson se *subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe ndalimit për të përfituar të mira, fonde publike nga kontratat publike, rrethanë, e cila duhet të merret për bazë në vlerësimin tërësor të rastit*, trupi gjykues analizon sa vijon.

**19.1.** Në vendimin e Komisionit në lidhje me konfliktin e interesit është evidentuar dhe konkluduar se për sa kohë që kontrata e qirasë e marrë në analizë mes subjektit të rivlerësimit dhe Bashkisë Kamëz, Tiranë, është lidhur si një përjashtim i rregulluar prej nenit 9 të ligjit nr. 139/2005 “Për vetëqeverisjen vendore”, si edhe është lidhur në një territor në të cilin subjekti nuk i ushtron funksionet e tij, është konkluduar se ajo është rregulluar si një përjashtim nga zbatimi i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) dhe ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke konkluduar në fund të këtij arsyetimi se subjekti nuk gjendet, për këto arsye, në kushtet e konfliktit të interesit.

---

<sup>42</sup> Vlera 30.000 GBP konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të viteve kur pretendohet se janë kryer investimet nga subjekti (2008,2009, 2010 dhe 2015).

**19.2.** Komisionerja Publike në ankim lidhur me konfliktin e interesit<sup>43</sup> pretendon se kontrata e qirasë është e lidhur për një qëllim publik nga një organ publik, për pasojë interpretimi i Komisionit se ajo del nga kufizimi i parashikuar nga neni 21, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, pika 4, germa “c” e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, duket se është një interpretim i zgjeruar, duke iu larguar qëllimit dhe frymës së vetë ligjit dhe interpretimit literal të pikës 1, të nenit 23 të këtij ligji. Sipas këtij shkak ankimi, dispozitat ligjore parashikojnë se *asnjë prokuror në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, nuk mund të lidhë kontratë me asnjë institucion publik [...]*.

**19.3.** Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit prapësoi qëndrimin e Komisioneres Publike, lidhur me kontratën e qirasë së katit të parë të objektit në rrugën “{\*\*\*}”, në Kamëz, Tiranë, duke pretenduar se ajo nuk e lidh këtë shkak ankimor me ndonjë nga pasojat e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi thekson se kjo kontratë duhet parë *në raport me etikën profesionale si mundësi apo shkak për cenimin e figurës së magjistratit* dhe se nuk ka arritur në konkluzionin se ky veprim i subjektit cenon ndonjë nga kriteret e tjera të rivlerësimit apo përbën një nga rrethanat e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, gjithashtu, subjekti evidentoi se, për më tepër, kontrata e qirasë e lidhur me Bashkinë Kamëz është jashtë periudhës së rivlerësimit.

**19.4.** Në analizë të situatës faktike të rezultuar nga hetimi administrativ, trupi gjykues konstaton se kontrata objekt verifikimi është lidhur në shtator të vitit 2022, pra, pas përpilimit të raportit të vlerësimit që ILDKPKI-ja ka kryer në përmbushje të kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, i cili mban datën 18.11.2019. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se në funksion të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, për rastin objekt shqyrtimi, analizës së Komisionit duhet t’i ishin nënshtruar veprimet e kryera nga subjekti, për të parë nëse ato janë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, për të shmangur situatat/marrëdhëniet që e vendosin atë kushtet e konfliktit të interesit.

Për sa më sipër, trupi gjykues, gjithashtu, vlerëson se prej Komisionit duhet të ishte analizuar nëse veprimet e subjektit janë konform përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005, duke e konsideruar, për këto arsye, si të pa justifikuar dhe jashtë fokusit të procesit të rivlerësimit, analizën që Komisioni bën lidhur me evidentimin e kompetencave që ka Bashkia Kamëz, në kuptim nenit 9 apo nenit 23 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili ka për

---

<sup>43</sup> Sipas shpjegimeve të vendimit të Komisionit, situatë e cila, sipas Komisioneres Publike, cilësohet si një marrëdhënie e krijuar në kushtet e konfliktit të interesit është si vijon:

**8.** Me qëllim realizimin e një hetimi të plotë e gjithëpërfshirës, subjekti informoi Komisionin se kati përdhe i objektit 3-katësh, njësi shërbimi i ndërtuar për biznes, nuk është përdorur për biznes para datës 19.09.2022 dhe në këtë datë, pra, më 19.09.2022, “[...] ky ambient është dhënë me qira me afat njëvjeçar për kopsht fëmijësh për llogari të Bashkisë K.. Për këtë është lidhur edhe kontrata e qirasë me nr. \*\*\* prot., datë 19.09.2022, me vlerë mujore 95.000 lekë. Nga kjo qira ende nuk janë përfituar të ardhura në llogarinë time bankare”. Sipas kontratës (neni 1), lidhur nga vetë ai si qiradhënës, me përfaqësuesen e Bashkisë K., zv/Kryetaren e Bashkisë, znj. U.E, Bashkia K., e ka marrë objektin me qira me qëllim përdorimin për kopshtin nr. \*\*\* “K”, sipas detyrave që kjo e fundit ka në realizimin e detyrave të saj funksionale, duke pasur parasysh funksionin e këtyre ambienteve objekt kontrate.

**8.1** Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Bashkia K. {\*\*\*}, rezulton se kjo e fundit kërkesën për marrje ambienteve me qira e ka publikuar në faqen zyrtare <https://kamza.gov.al>. Grupi i Punës, i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ka bërë përzgjedhjen e ofertës fituese dhe pas përzgjedhjes është lidhur kontrata e sipërpërmendur.

objekt organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatës. Pavarësisht mosidentifikimit të saktë të ligjit të zbatueshëm, trupi gjykues, gjithashtu, vëren se edhe në kontekstin e një analize kaq të gjerë, sërish rezulton se në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk përcaktohet se ushtrimi i kompetencave nga organet e qeverisjes vendore mund të kryhet nga subjektet duke shmangur përcaktimet e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

19.5. Në vendimin objekti shqyrtimi të Komisionit, analizohet se meqenëse kontrata e lidhur ka natyrë publike, fakti se qiraja është lidhur për qëllim të përdorimit të ambientit në pronësi të subjektit për kopsht publik, e përfshin atë në rastet që përjashtohen nga ndalimi i pikës 1, të nenit 4 të ligjit nr. 9367/2005, që do ta vendoste subjektin në situatën e konfliktit të interesit. Lidhur me këtë qëndrim, trupi gjykues vëren se neni 4 i ligjit nr. 9367/2005, përcakton fushën e zbatimit të këtij ligji, e cila ndryshe nga interpretimi që i bën Komisioni nuk përjashton kontratat e lidhura për qëllime publike. Nga analizimi në tërësi i ligjit nr. 9367/2005, trupi gjykues çmon se në rastin konkret Komisioni duhet të ishte ndalur në konsiderimin e përmbajtjes së nenit 21 të këtij ligji të emërtuar “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, i cili, në pikën 1 të tij, ka të përcaktuar se: *1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.* Kjo dispozitë ligjore në mënyrë të qartë ka përcaktuar ndalimin që gjyqtarët dhe prokurorët të lidhin kontrata me institucione publike, pa e shmangur këtë ndalim në rastet kur kemi të bëjmë me kontrata publike me palë institucione publike. Si të tilla mund të klasifikohen pothuajse të gjitha kontratat e lidhura nga organet e administratës së pushtetit qendror dhe atij lokal të lidhura me qëllim realizimin e detyrave dhe kompetencave që këto organe kanë në përputhje me veprimtarinë që kryejnë, e cila gjithmonë udhëhiqet nga mbrojtja e interesit publik, interpretim i cili do të bënte pothuaj të pazbatueshme dispozitën e mësipërme sipas një leximi aspak teleologjik.

19.6. Në referim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se përmbajtja e pikës 1, të nenit 21 të ligjit nr. 9367/2005 ka si qëllim të ndalojë gjyqtarët dhe prokurorët të përfitojnë kontrata që financohen me fonde publike (*siç është kontrata e qirasë për kopsht e lidhur ndërmjet subjektit dhe Bashkisë Kamëz*), me qëllim shmangien e konfliktit të interesit. Për më tepër, pika 1, e nenit 21 të ligjit, detyrimin për prokurorët dhe gjyqtarët për të mos lidhur kontrata me institucione publike nuk e lidh me vendin në të cilin ata ushtrojnë detyrën, por e shtrin në të gjithë territorin e Republikës. Në këto kushte, arsyetimi i Komisionit se *pika 1 e nenit 21 nuk mund të zbatohet, pasi ligjvënësi ka parashikuar disa përjashtime specifike, listuar në rend zbritës në pikën 4, të nenit 21 të ligjit*, duket se nuk i përshtatet rastit objekt shqyrtimi, pasi pika 4 e nenit 21 parashikon se *nga ndalimet e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës: [...] c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve*, situata që nuk provohen se ekzistojnë në rastin objekt shqyrtimi. Në rastin konkret, kontrata e qirasë, siç e ka shpjeguar edhe vetë subjekti në shpjegimet që ka dhënë në Komision, është bërë në përputhje me

kompetencat që bashkia ka si organ i qeverisjes vendore, pra, është bërë në zbatim të ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke aplikuar dispozitat e Kodit Civil, i cili është ligji i vetëm që rregullon marrëdhëniet e qiradhënies.

Konkluzionet e mësipërme u vlerësuan prej trupi gjykues edhe nën dritën e kërkimit të Komisioneres Publike, për t’i vendosur ato në kuadër të një vlerësimi të etikës dhe sjelljes së subjektit të rivlerësimit, elementë të cilët rezultojnë t’i përkasin kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratëve në Republikën e Shqipërisë”, përderisa kjo çështje nuk është ngritur si një çështje që mund të analizohet brenda kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, meqenëse krijimi i të ardhurave prej saj del jashtë periudhës së rivlerësimit. Në këtë kuadër, trupi gjykues vlerësoi se konstatimi i gjendjes së konfliktit të interesit si një çështje e etikës së prokurorit, e palidhur me sjelljen gjyqësore/profesionale të tij, pasi ai i ka ushtruar funksionet në një territor tjetër, i cili nuk administrohet nga Bashkia Kamëz, Tiranë, nuk mund të prodhojë problematikë përcaktuese për këtë kriter dhe as në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016.

19.7. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtimin pretendimin e Komisioneres Publike, lidhur me çështjen e konfliktit të interesit, e gjeti atë të drejtë dhe arsyetimin e vendimit të Komisionit, për përjashtimin e rastit të analizuar nga zbatimi i ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si të gabuar e të pabazuar në ligj. Trupi gjykues, pavarësisht analizës dhe konkluzionit të mësipërme, lidhur me konfliktin e interesit, pasi e vlerësoi atë, arriti në konkluzionin se pesha e tij nuk është përcaktuese në marrjen e një vendimi për procesin e rivlerësimit të subjektit, në kuadër të zbatimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

20. Trupi gjykues, përveç shkaqeve të ankimit të analizuara më sipër, analizoi dhe vlerësoi dhe dy denoncimet e paraqitura prej publikut të depozituara në Kolegj nga denoncuesit R. D. dhe Sh. B., të cilët plotësonin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, të përmendura në pjesën hyrëse të këtij vendimi, për të cilat u evidentuan problematika lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit edhe prej Komisioneres Publike.

20.1. Lidhur me denoncimin e shtetasit R. D., nga shqyrtimi i pretendimeve të denoncuesit dhe të dhënave që burojnë nga aktet e administruara nga trupi gjykues në funksion të hetimit të këtij denoncimi, rezulton se subjekti i rivlerësimit me cilësinë e prokurorit të çështjes ka regjistruar në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, procedimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2017, të regjistruar për veprën penale të “vetëgjyqësisë” të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Nga analiza e akteve të paraqitura në gjykim prej vetë subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ndonëse subjekti ka regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale procedimin penal për kryerjen e veprës penale të “vetëgjyqësisë”, ka kryer në të hetime rreth veprës penale të falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Nga aktet e paraqitura, përfshi vendimet gjyqësore të cilat kanë prishur vendimin e subjektit për pushimin e çështjes lidhur me veprën penale të “vetëgjyqësisë”, është potencuar dhe lënë detyrë kryerja e akteve të ekspertimit nga Instituti i Policisë Shkencore për ekzaminimin grafik të dokumenteve, të cilat duket se krijojnë të

drejta pronësie për palët në konflikt, duke detyruar organin e akuzës të përsërisë këto akte më shumë se një herë. Subjekti rezulton se ka kryer hetime dhe ka riekspertuar dokumente në drejtim të identifikimin/zbulimit të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, pa regjistruar në regjistër njoftimin e marrë për kryerjen e një veprë tillë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, i cili detyron prokurorin të regjistrojë çdo njoftim që merr për një ngjarje kriminale në këtë regjistër. Në vijim të kësaj mënyre procedimi, subjekti rezulton se ka pushuar procedimin penal të regjistruar për veprën penale të “vetëgjyqësisë” në datën 10.02.2021 dhe në brendësi të tij, në mënyrë narrative ka pushur edhe hetimet për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, sepse veprimtaria kriminale e dyshuar që ishte konsumuar si e kualifikuar prej kësaj veprë ishte në tejkalim të afateve të parashkrimit. Në kushtet kur vendimi i pushimit, i cili pushon hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodi Penal, e cila është kundërvajtje penale, nuk i nënshtrohet kontrollit gjyqësor, sipas parashikimit të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se artificialisht ka mbetur jashtë kontrollit gjyqësor edhe pushimi në thelb i hetimeve për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, e cila nuk ishte e regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, ndërsa për të cilën efektivisht ishin kryer hetime të thelluara nga subjekti i rivlerësimit.

**20.2.** Për sa më lart, trupi gjykues, në analizë të çështjeve të parashtruara nga denoncuesi R. D.<sup>44</sup>, ndan të njëjtin qëndrim me Komisioneren Publike, për sa i përket evidentimit të mangësive në njohuritë e ligjit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me përcaktimet e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon detyrimin për regjistrimin në regjistrin e njoftimeve të veprave penale të çdo njoftimi që vjen për kryerjen e tyre, si një parakusht për ushtrimin e ndjekjes penale në funksion të garantimit të të drejtave të palëve dhe ushtrimit të kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë e prokurorit.

**20.3.** Lidhur me denoncimin e shtetasit Sh. B., trupi gjykues mori në shqyrtim aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit lidhur me ekzekutimin e një vendimi penal dënimi në ngarkim të tij të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Sipas këtyre akteve, rezulton se denoncuesi është dënuar me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale për uljen e dënimit në 1/3, duke e dënuar me 200.000 lekë gjobë. Ky vendim është ndryshuar me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër duke e deklaruar fajtor të pandehurin Sh. B., për kryerjen e veprës penale “Kanosje” të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale*

---

<sup>44</sup> Komisionerja Publike në parashtrimet e dhëna gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, lidhur me denoncimin e shtetasit R. D., evidentoi se :

*Rezultoi se vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2017, akti më i fundit procedural i gjendur në këtë dokumentacionin e administruar është urdhri “Për delegim dhe kryerjen e veprimeve hetimore”, i datës 05.06.2023. Ky procedim penal është regjistruar më datë 03.10.2017, për kundërvajtjen penale të “vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, dhe gjendja e këtij procedimi penal ka qenë në hetim në datën 05.06.2023. Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2017, është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin e datës 07.02.2019, i lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me vendimin e datës 14.5.2019. Në vazhdim, vendimi i dyti në radhë për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 03.10.2017, për kundërvajtjen penale të “vetëgjyqësisë” është ankimuar në gjykatë, e cila, me vendimin e datës 08.04.2021, ka vendosur pranimin e ankimit, i ankimuar ky vendim nga Prokuroria Dibër, dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 14.12.2022, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.*

*duke iu ulur 1/3 e dënimit i pandehuri Sh. B. dënohet me 2 muaj burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi dhe do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.*

Pas marrjes së këtij vendimi rezulton të jetë lëshuar urdhri i ekzekutimit të tij më datë 01.09.2016 nga prokurorja E. C.. Rezulton se ky urdhër ekzekutimi nuk është ekzekutuar dhe, për pasojë, denoncuesi nuk e ka vuajtur dënimin e dhënë. Në vijim me anë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2022, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të dënuarit dhe të prokurorit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pas marrjes së këtij vendimi subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë sërish një urdhër të ri ekzekutimi për vendimin e dënimit të denoncuesit. Pas kërkesave të denoncuesit, subjekti ka revokuar urdhrin e nxjerrë prej tij për ekzekutimin e vendimit me arsyetimin se është shuar dënimi penal i dhënë ndaj denoncuesit. Në të njëjtë kohë, subjekti i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për të konstatuar shuarjen e dënimit të denoncuesit, kërkesë e cila, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.11.2023, të kësaj gjykate, është refuzuar.

**20.4.** Trupi gjykues, në veprimtarinë e mësipërme procedurale të kryer prej subjektit në rolin e prokurorit të ekzekutimit të vendimit, konstaton disa parregullsi që lidhen, si me llogaritjen e afatit për shuarjen e dënimit penal, parregullsi të cilat u abstraguan për shkak të ndërhyrjes së gjykatës dhe qëndrimit të mbajtur prej saj, por edhe me kompetencën e prokurorit për të konstatuar këtë fakt juridik.

**20.5.** Për sa më lart, trupi gjykues gjeti të drejtë edhe qëndrimin e Komisioneres Publike, lidhur me mangësinë profesionale të evidentuara në rastin e praktikës për ekzekutimin e një vendimi penal, referuar në denoncimin e denoncuesit Sh. B.<sup>45</sup>, në të cilin subjekti duket se ka demonstruar mangësi në njohuritë e ligjit, të paktën në nxjerrjen e një urdhri për revokimin e një urdhri të mëparshëm për ekzekutimin e një vendimi penal, duke arsyetuar mbi rrethanat që kanë shuar dënimin penal, ndërsa kjo e drejtë i takon vetëm organit gjyqësor, sipas parashikimit të nenit 480 të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>45</sup> Komisionerja Publike në parashtrimet e dhëna gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, lidhur me denoncimin e shtetasit Sh. B., evidentoi se:

Lidhur me praktikën e vënies në ekzekutim të vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, konstatohet se: Për vendimin penal me nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, fillimisht ka dalë urdhri i ekzekutimit nga një tjetër subjekt rivlerësimi me urdhrin e datës 01.09.2016, i cili rezulton se nuk është ekzekutuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.09.2023, i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër me lëndë: dërgohet vendim penal i formës së prerë, ku përcillen vendimi nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, që i përket të pandehurit/kërkuarit Sh. B. dhe një kopje të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2022, të Gjykatës së Lartë. Subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 26.09.2023, “Për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë [...]”, sipas së cilit urdhërohet arrestimi dhe transferimi i të dënuarit Sh. B. ku të mbahet për një periudhë 2 muaj burgim, duke filluar llogaritja e afateve nga dita e ekzekutimit të këtij urdhri. Veprime të mëtejshme të subjektit, z. Buci, në funksionin e prokurorit, rezultojnë këto në vijim, vendimi i datës 03.11.2023/45, “Për revokimin e urdhrin të ekzekutimit [...]”, sipas së cilit citojmë: “[...] ekzekutimi i dënimit të caktuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, i cili ka marrë formë të prerë më datë 29.06.2016, në bazë të nenit 68, germës “c” të Kodit Penal, është parashkruar, për pasojë dënimi i dhënë me këtë vendim duhet të deklarohet i shuar, prandaj duhet të revokohet urdhri i ekzekutimit [...]”, dhe kërkesën e datës 03.11.2023, drejtuar gjykatës, me objekt: shuarjen e dënimit të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2015, ku si bazë ligjore vendos edhe vendimin penal unifikues me nr. 7, datë 11.10.2002, të Gjykatës së Lartë. Gjykata, me vendimin e datës 07.11.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, ku në arsyetimin e vendimit, gjykata ka përdorur edhe referenca të jurisprudencës së aplikueshme për çështjen në gjykim, konkretisht, vendimin penal unifikues nr. 2, datë 03.11.2014.



20.6. Pavarësisht mangësive të konstatuara në dy çështjet e evidentuara prej denoncimeve, trupi gjykues, pasi i vlerësoi ato, arriti në konkluzionin se pesha e tyre nuk është përcaktuese në marrjen e një vendimi për procesin e rivlerësimit të subjektit, në kuadër të zbatimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21. Në përfundim, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionin e arritur për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se ankimi i paraqitur prej Komisioneres Publike është i drejtë dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 651, datë 27.04.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, është një vendim i cili nuk është marrë në vlerësim të drejtë të provave të administruara gjatë hetimit e as në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar dhe, si i tillë, ai duhet të ndryshohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 651, datë 27.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Urim Buci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 26.02.2024.

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**  
*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**  
*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**  
*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**  
*nënshkrimi*